


# Analiza e Nevojave dhe Identifikimi i Problemeve të Diasporës Kosovare

Qërshor, 2024





Ky raport u realizua me mbështetjen e projektit rajonal “SMART Balkans – Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkët në Ballkanin Perëndimor” të zbatuar nga Qendra për Promovimin Shoqërisë Civile (CPCD) në bashkëpunim me Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), dhe Qendra për Kërkim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe i mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë (NMFA). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e GERMIN si zbatues i projektit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëvpamjet e Ministrisë së Punëve të Jashtme Norvegjeze (NMFA).

# Përmbajtja

|   |    |
|---|----|
| Përmbledhje Ekzekutive .....  | 5  |
| 1. Hyrje .....  | 6  |
| 2. Qasja metodologjike .....  | 8  |
| 3. Çështja e diasporës nga perspektiva institucionale .....           | 9  |
| 4. Vlerësimi i sfidave dhe mundësive të diasporës kosovare .....      | 13 |
| 4.1 Investimet dhe Diaspora .....                                     | 14 |
| 4.1.1 Mungesa e informimit dhe udhëzimit .....                        | 17 |
| 4.1.2 Pasiguria politike dhe juridike .....                           | 17 |
| 4.1.3 Mungesa e sundimit të ligjit.....                               | 18 |
| 4.2 Mësimi plotësues në gjuhën shqipe në diasporë .....               | 18 |
| 4.3 Mungesa e qendrave kulturore në diasporë .....                    | 20 |
| 4.4 Votimi në diasporë .....  | 21 |
| 4.5 Sfida të tjera .....  | 23 |
| 4.5.1 Kartoni i Gjellbër .....  | 23 |
| 4.5.2 Pensionet.....  | 24 |
| 4.5.3 Njohja e Kosovës si vend i origjinës.....                       | 24 |
| 5. Aspekte krahasuese të strategjive të suksesshme të diasporës ..... | 25 |
| 5.1 Moldavia .....  | 25 |
| 5.2 Kroacia.....  | 25 |
| 5.3 Izraeli .....   | 26 |
| 6. Përfundime dhe Rekomandime.....                                    | 28 |
| 7. Referencat .....   | 31 |

## Përmbledhje Ekzekutive

Ky raport është vazhdim i përpjekjeve të organizatës Germin për të kuptuar nevojat, sfidat dhe mundësitë e diasporës kosovare. Raporti rithekson kontributin e diasporës në Kosovë përmes remitancave, avokimit politik dhe lidhjes kulturore në njërën anë dhe potencialit të diasporës për ndikim më të gjerë në zhvillimet ekonomike, politike dhe sociale, në anën tjetër. Potenciali shumëdimensional i diasporës rrezikon të mbetet i pashfrytëzuar në rast të moskoordinimit institucional dhe krijimit të kushteve dhe mundësive për ta kanalizuar atë. Përkundër limitimeve metodologjike, raporti është vazhdimësi e punës së Germin duke sintetizuar gjetjet dhe mësimet kyçe në mënyrë që të ofrojë rekomandime konkrete tek institucionet e mandatuara për angazhimin e diasporës dhe palët e tjera me interes.

Raporti nis me një shqyrtim të qasjes institucionale ndaj diasporës për të vijuar tutje me vlerësimin e sfidave dhe mundësive të diasporës në jetën politike dhe publike. Raporti poashtu ofron një qasje krahasuese me vendet të tjera të cilat në mënyrë të suksesshme kanë tërhequr diasporën dhe potencialin e saj, dhe rrjedhimisht mund të shërbejnë si modele për hartuesit e politikave.

Ky raport është gjithashtu një analizë e përpjekjeve për të kapërcyer pengesat në mes të mundësisë dhe aspiratave të diasporës dhe politikave që i japin formë këtyrë mundësive. Shpresa është që institucionet relevante t'i zbërthejnë rekomandimet në veprime konkrete në linjë me nevojat, gatishmërinë dhe pritjet e diasporës. Misioni jonë si shoqëri duhet të mbetet tek forcimi i lidhjes me diasporën duke e parë rolin e saj përtej remitancave dhe interesave ekonomike, si partner kyç dhe pjesë integrale e shoqërisë në zhvillimin afatgjatë të Kosovës.

# 1. Hyrje

Në nivel global, numri i njerëzve të cilët jetojnë jashtë vendit të tyre të origjinës është trefishuar në mënyrë drastike në 50 vitet e fundit. Sipas raportit të Organizatës Botërore për Migrim (IOM) numri total i migrantëve konsiderohet të ketë tejkaluar 281 milionë, 128 milionë më shumë krahasuar me vitin 1990 dhe mbi 3 herë më shumë krahasuar me vitin 1970 (IOM, 2022). Diasporat e shumë kombeve, të motivuar nga një numër i faktorëve si lidhja emocionale me vendin amë, mundësitë ekonomike dhe sociale, historikisht kanë kontribuar në komunitetet e tyre (Soski, 2015) dhe kanë potencial për të luajtur rol kyç në zhvillimin ekonomik të vendeve të origjinës përtej rolit të tyre tradicional si dërgues të remitancave.

Përderisa në të kaluarën politika e diasporës apo siç njihet në termin anglisht “diaspora politics” në nivel global nuk ka zgjuar ndonjë interesim të jashtëzakonshëm për studim (përveç disa rasteve tek-tuk), sot angazhimi dhe përfshirja politike e diasporës është temë e pranishme gjithandej në politikën e përditshme. Kjo sipas Adamson (2016) ka të bëjë kryesisht me ndryshimet që përcillen me globalizmin, teknologjitë e reja dhe mediat globale të komunikimit të cilat ju mundësojnë qytetarëve nga çdo kënd i botës të kyçen në politikat e vendit të tyre amë në kohë reale. Përshembull, eksperti i çështjeve të diasporës, Kingsley Aikins, thekson se suksesi i Kinës si fuqi prodhuese, i Indisë si qendër globale e teknologjisë, dhe i Izraelit si shteti i “start-ups”, lidhet drejtpërdrejt me rrjetëzimin efektiv të diasporave të tyre (Aikins, 2014). Ai përdor këto shembuj për të ilustruar rëndësinë vitale të rrjetëve të diasporës në zhvillimin e këtyre vendeve.

Roli dhe potenciali i diasporës shqiptare në zhvillimin e përgjithshëm socio-politik në Kosovë është gjerësisht i pranuar nga institucionet shtetërore, popullsia lokale dhe vetë diaspora nisur nga fakti që Kosova përbën një nga shtetet me numër të madh të diasporës krahasuar me numrin total të popullësisë. Kjo nuk është e rastësishme marrë për bazë kontekstin politik dhe historik të Kosovës posaçërisht gjatë viteve të 90-ta. Sidoqoftë, vala e parë e migrimit në Kosovë kishte filluar qysh në vitet e 60-ta të shekullit të kaluar (Përteshi 2020), pikërisht për shkak të pozitës jo të favorshme politike dhe ekonomike të Kosovës në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugollsisë (RSFJ).

Para pavarësisë së Kosovës, diaspora ka qenë avokuesi më i fuqishëm i kauzës politike të saj dhe kontribuesi më i madh ekonomik. Përveç avokimit për pavarësi, diaspora ka mbrojtur me fanatizëm gjuhën, kulturën dhe identitetin shqiptar në vendet ku kanë jetuar dhe përtej. Por, realiteti sot duket më ndryshe ashtu siç edhe vetë përbërja e diasporës. Kjo e bën edhe më tej të rëndësishme nevojën për studimin e nevojave dhe sfidave të diasporës, të cilat do të lehtësonin përfshirjen e tyre në jetën politike, ekonomike dhe sociale. Çdo studim, diskutim, konferencë etj., që trajton rolin e diasporës në politik-bërje në nivel kombëtar apo regjional, në një formë apo tjetër thekson diasporën si një burim të pashfrytëzuar me potencial të jashtëzakonshëm për Kosovën. Duke ditur të kaluarën e Kosovës dhe sfidat e saj aktuale, kjo çështje merr një formë dhe rëndësi të veçantë në kontekstin tonë për shkak të numrit, natyrës dhe lidhjes emocionale që diaspora shqiptare ka me vendin amë.

Megjithatë, përfshirja e diasporës në mënyrë të strukturuar dhe aktive në politik-bërje apo zhvillim të qëndrueshëm ekonomik është më lehtë e thënë sesa e bërë. Deri më tani asnjë qeveri që nga paslufta nuk ja ka dalë që diasporën ta trajtojë si hisedarë dhe jo vetëm si instrument të politikbërjes. Thënë këto,

---

analiza synon që të identifikojë nevojat dhe sfidat e diasporës me qëllim të ofrimit të rekomandimeve strategjike për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës (MPJD), Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë të Republikës së Kosovës (KPPJD), institucionet e tjera relevante dhe grupet e interesit.

Përkundër kufizimeve dhe limitimeve metodologjike për shkak të mungesës së të dhënave të plota dhe kredibile, ky raport është vazhdimësi e punës së Germin e cila për të kuptuar dinamikën e diasporës në përgjithësi dhe asaj kosovare në veçanti. Germin ka bërë përpjekje që të eksplorë mbi potencialin e dhe sfidave e diasporës përmes projekteve të ndryshme të cilat targetojnë çështjet e remitancave, mësimit plotësues të gjuhës shqipe, investimeve direkte, përfaqësimit politik, etj. Ky raport tenton që sfidat, gjetjet kryesore dhe mësimet, t'i diskutojë në një vend në mënyrë që të ofrojë rekomandime konkrete për institucionet e Kosovës dhe jo vetëm. Ai nis me një shqyrtim të qasjes institucionale ndaj diasporës për të vijuar tutje me vlerësimin e sfidave dhe mundësive të përmirësimit të rolit të diasporës në jetën politike dhe publike. Poashtu, për të pasuruar më tutje analizën, raporti ofron një qasje krahasuese me vendet të tjera të cilat në mënyrë të suksesshme kanë tërhequr diasporën dhe potencialin e saj, dhe rrjedhimisht mund të shërbejnë si modele për hartuesit e politikave.

## 2. Qasja metodologjike

Qasja metodologjike e kësaj analize bazohet fillimisht në një rishikim të detajuar të studimeve ekzistuese të Germin dhe organizatave të tjera që merren me çështjet e diasporës, me qëllim të të kuptuarit të tematikës dhe kornizimit të kontekstit të saj. Për të ndërtuar një bazë solide të sfidave dhe mundësive që has diaspora, ky raport mbështetet në një sërë burimesh të dhënash shtesë, të cilat përfshijnë: a) të dhënat zyrtare të disponueshme publikisht në faqen e MPJD; b) procesverbalet e të gjitha takimeve të KPPJD-së të legjislaturës aktuale; dhe c) diskutimet e Germin me komunitetin e diasporës në kuadër të projekteve të ndryshme për përfshirjen e diasporës në procesin e politikëbërjes. Gjithashtu, intervistat e gjysmë-strukturuara do të shërbejnë si burime parësore të të dhënave për këtë analizë.

Germin organizoi dy takime në Gjermani, më 12 dhjetor në Ambasadën e Kosovës në Berlin dhe më 14 dhjetor në Konsullatën e Kosovës në Hamburg, të cilat shërbyen si mbështetje shtesë për të strukturuar temat në këtë studim. Në këto takime, të zhvilluara në formën e grupeve të fokusit, morën pjesë përfaqësues të komunitetit të diasporës, të misioneve diplomatike kosovare në Gjermani dhe përfaqësues të Germin-it. Për më tepër, shtatë (7) persona të përzgjedhur nga Germin u ftuan për intervista, nga të cilët katër u përgjigjën dhe u intervistuan me sukses më 10 dhe 11 janar 2024. Këto intervista, të cilat ishin gjysmë të strukturuar dhe përmblanin pyetje të hapura, u kryen me qëllim që të lejonin bashkëbiseduesit të ndanin lirisht përvojat, nevojat dhe njohuritë e tyre rreth angazhimit të diasporës.

Të dhënat e marra nga këto takime dhe intervista u transkriptuan për të identifikuar temat kryesore, çështjet e përsëritura dhe njohuritë kyçe që lidhen me nevojat e diasporës. Këto informacione u kombinuan me gjetjet paraprake nga studimet e Germin dhe takimet me diasporën, për të siguruar një përmbledhje gjithëpërfshirëse të sfidave dhe mundësive për diasporën. Emrat e të intervistuarve nuk janë bërë publike me qëllim të respektimit të parimit të anonimitetit dhe konfidencialitetit sipas kërkesës së vetë intervistuesve.



### 3. Çështja e diasporës nga perspektiva institucionale

Para se të identifikojmë sfidat dhe problemet e diasporës karshi politikbërjes, është thelbësore që fillimisht të analizojmë gjendjen aktuale të trajtimit të temës së diasporës nga institucionet vendore. Për qëllim të kësaj analize, do të analizojmë qasjen e MPJD-së dhe KPPJD karshi diasporës si dy institucionet kyçe të mandatuara për të trajtuar çështjet e diasporës.

Sipas [Ligjit Aktual për Diasporën](#)<sup>1</sup> – i cili është për ndryshim e sipër – ish Ministria për Diasporë, tash pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është përgjegjëse kryesore për hartimin, propozimin dhe zbatimin e politikave për legjislacionin mbi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me diasporën si dhe vlerësimin dhe/apo mbikëqyrjen e tyre (LIGJI NR. 04/L – 095 , 2012). Ndër këto çështje me rëndësi të veçantë për këtë analizë janë:

- a) Çështja e plan-programeve mësimore të gjuhës shqipe nëpër diasporë;
- b) Regjistri i mërgimtarëve;
- c) Organizimi i mërgimtarëve në diasporë dhe lidhja e tyre me institucionet dhe shoqërinë civil në Kosovë;
- d) Ofrimi i informatave, koordinimi dhe përkrahja e investimeve të mërgimtarëve në Kosovë.

Pas zgjedhjeve të fundit qendrore të 14 shkurtit të vitit 2021, qeveria aktuale nën udhëheqjen e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), vendosi për shkrirjen e Ministrisë për Diasporës me Ministrinë e Punëve të Jashtme ndonëse ky vendim nga disa njohës të çështjeve u konsiderua jo i duhur. Ministria e dikurshme e Diasporës tani është shndërruar në departament të veçantë për Diasporë i cili përbëhet nga tre divizione (për të cilat nuk ofrohet asnjë informatë rreth veprimtarisë së tyre në faqen e ministrisë), përkatësisht:

- a) Divizioni për Komunikim dhe Koordinim në Diasporë,
- b) Divizioni për Kulturë, Rini dhe Sport në Diasporë,
- c) Divizioni për Arsim në Diasporë.

Navigimi në faqen zyrtare të [MPJD-së](#) si adresa e parë ku secili qytetar mund të marrë informatat në lidhje me punën e këtij dikasteri qeveritar, të jep të dhëna shumë të kufizuara. Navigimi në faqen zyrtare të MPJD-së si adresa e parë ku secili qytetar mund të marrë informatat në lidhje me punën e këtij dikasteri qeveritar, të jep të dhëna shumë të kufizuara në lidhje me diasporën. Ndërkohë, seksioni i Diasporës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës deri më datë 17 prill 2024 (kur u shkrua raporti) mbetet plotësisht i zbrastë. Për të analizuar punën, politikat dhe të arriturat e MPJD-së karshi diasporës, janë analizuar të gjitha njoftimet të cilat në faqen zyrtare të MPJD-së janë të qasshme vetëm nga tetori i vitit 2022, ndonëse qëllimi ishte që të analizohen të gjitha lajmet që nga konstituimi i qeverisë aktuale.

Sidoqoftë, mungesa e informatave në faqen zyrtare të MPJD-së u plotësua nga të dhënat e marra në intervistën e realizuar më zyrtarin e lartë për diasporë dhe njoftimet në faqen e MPJD-së në Facebook nga 22 marsi i vitit 2021 kur ministrja aktuale znj. Donika Gërvalla - Schwarz morri mandatin.

<sup>1</sup>Shih: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2831>

Sipas të intervistuarit nga MPJD, qeveria aktuale ka një qasje plotësisht të re ndaj diasporës duke mos e parë atë më si pjesë të shoqërisë kosovare që jeton jashtë vendit me qëllim të mbijetesës apo furnizuesit me remitanca, por si “...partner me qëllimin e përbashkët për përfitime të dyanshme” (Intervistë me H.R, komunikim personal, 10 janar 2024).

Për më tepër, sipas zyrtarit ministria në fjalë është e vetëdijshme edhe për ndryshimin e brendshëm të diasporës e cila sot është më e fortë se kurrë me suksese mbresëlënëse në fusha të ndryshme. Pra, fokusi i MPJD-së është posaçërisht e drejtuar tek kjo shtresë e diasporës e cila është integruar në vendet ku jeton në muzikë, art, sport, kulturë, shkencë, etj. Kjo është e nënkuptuar duke konsideruar që diaspora e Kosovës e cila filloi valën e migrimit qysh nga vitet e 60-ta të shekullit të kaluar, dallon drastikisht me mënyrën se si duket sot diaspora.

Para marrjes së mandatit, qeveria aktuale – e cila në zgjedhjet e fundit gëzoi mbështetje masive nga diaspora – kritikonte ashpër qeveritë e kaluara për qasjen institucionale ndaj diasporës me theks të veçantë në kornizën ligjore. Një gjë e tillë siç do ta shohim tek analiza e proces-verbaleve të KPPJD u përmend shumë herë nga raportimet e rregullta të ministrës së MPJD-së dhe KPPJD. Ndonëse ndryshimi i ligjit aktual për diasporën u premtua qysh në vitin 2021, ligji ende nuk ka dalur në diskutim publik në kohën kur po shkruhet kjo analizë. Sipas informatave zyrtare, MPJD ka krijuar një grup punues i cili është përgjegjës për draftimin e Ligjit të ri për Diasporën dhe është në fazën finale të daljes në diskutim publik. MPJD ka në plan po ashtu që në diskutim të përfshijë edhe diasporën përmes takimeve fizike dhe virtuale. Në të njëjtin proces është edhe Strategjia e re për Angazhimin e Diasporës.

Për të kuptuar më qartë punën e MPJD-së, në paragrafët vijues është përmbledhur shkurtimisht puna e MPJD-së karshi diasporës në tre vitet e fundit ndërsa në pjesën e aneksit mund të gjeni një pasqyrë të detajuar kronologjike të ngjarjeve, iniciativave dhe vendimeve të ndërmarra nga MPJD për periudhën mars 2021 - prill 2024 për të shënuar përpjekjet, arritjet konkrete dhe identifikimin e fushave sfiduese karshi diasporës.

Një nga elementet definuese të punës së MPJD-së përgjatë tri viteve të fundit janë përpjekjet për bashkëbisedim me diasporën nga Kosova qoftë përmes programeve në Kosovë apo takimeve dhe konsultimeve në diasporë. Këto përpjekje filluan në verën e vitit 2021 – në kohën kur diaspora zakonisht viziton Kosovën – në kuadër të të ashtuquajturit “Dialogu me Diasporën” i cili sipas MPJD-së sinjalizon draftimin e strategjisë të re për angazhimin e diasporës por edhe qasjes së re të Qeverisë karshi saj. MPJD në korrikun e vitit 2022 po ashtu lancoi programin “Karvani i Diasporës” i cili gjatë verës rrugëtoi nëpër qytete të ndryshme të Kosovës me qëllim të bashkëbisedimit dhe shkëmbimit të ideve më diasporën. Gjate kësaj periudhe u themelua edhe Kolegjiumi i Diasporës në kuadër të Asociacionit të Komunave të Kosovës. Kolegjiumi shënon përpjekjen e parë të formalizimit dhe bashkërendimit të nivelit qendror dhe atij lokal rreth aktiviteteve për diasporën dhe angazhimin e diasporës në investime dhe politika zhvillimore në nivel lokal.

Takimet me komunitetin shqiptar në diasporë, MPJD i realizoi pothuajse kudo ku pati takime zyrtare nëpër Evropë dhe gjatë ndërsa ato u kurorëzuan me lancimin e platformës “Shijo Kosovën” në gusht të vitit 2023. Shijo Kosovën është platforma e parë e dedikuar kryekëput për informimin dhe angazhimin

<sup>2</sup>Shënim: Ligji është përmend që do të dal në diskutim publik qysh nga janari i vitit <sup>2024</sup>. Deri më tani, nuk ka ndonjë indikacion për një gjë të tillë.

e diasporës. Në nëntor vitit 2022, MPJD zgjeroi fokusin e saj kundrejt integritit të gjeneratave të reja të diasporës në Kosovë duke lancuar projektin “Diplomacia Qytetare”. Kjo shënon programin e parë për të institucionalizuar diplomacinë qytetare më të rinjtë nga diaspora. Programi suksesshëm u aprovua për dy vite 2023 – 2025 dhe parasheh angazhimin e të rinjëve nga diaspora nëpër institucione shtetërore. Përveç këtij projekti, lajm i mirë ishte organizimi i forumit ndërkombëtar “Ulpiana” në nëntor të vitit 2023 ku u diskutua kryekëput për trendet e angazhimit të diasporës dhe rolit të saj në zhvillimin e gjithmbarshëm të vendit.

Së fundi, MPJD në bashkëpunim me ASK kanë lancuar platformën shtetërore e-Diaspora, e cila synon regjistrimin e qytetarëve kosovarë në Diasporë në kuadër të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave.

Përkundër këtyre ngjarjeve, në aspektin ligjor nuk është shënuar ndonjë progres. Strategjia e kaluar e cila skadoi në vitin 2018 ende nuk është zëvendësuar nga strategjia e re meqë draft-strategjia është në pritje të daljes në diskutim publik. Në anën tjetër, nuk ka ndonjë informatë rreth ligjit të ri për diasporën.

Para se të elaborojmë më tutje këto ngjarje dhe disa hapa të tjerë që MPJD ka ndërmarrë kundrejt diasporës është e rëndësishme që të zhvendosim fokusin tonë tek dimensionin parlamentar i angazhimit të diasporës.

Përveç MPJD-së si aktorin kryesor politik që merret me diasporën, Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë ([KPPJD](#)) është institucioni tjetër me rëndësi për këtë analizë. KPPJD është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me diasporën dhe sigurisht mbikëqyrjen e punës së ekzekutivit në këto çështje duke përfshirë ligjet, projektligjet, buxhetin, programet dhe aktivitetet. Komisioni si i tillë ka të drejtë për kërkimin e të dhënave konkrete duke përfshirë raportimin e drejtpërdrejtë të ministrave dhe personave të tjerë përgjegjës. Pra, Ministria e MPJD-së raporton direkt për punën e saj para Komisionit. Me qëllim të analizës së punës dhe rolit të Komisionit në lidhje me çështjet e diasporës, janë shqyrtuar të gjitha proceset verbale të Komisionit që nga takimi i parë i Komisionit të ri Parlamentar pas zgjedhjeve të 14 shkurtit 2021, më saktësisht më datë 13 prill 2021.

Takimi i parë i Komisionit me Ministrën Gërvalla-Schwarz, u mbajt më 25 maj të vitit 2021, ku nga ministrja u përmend nevoja për nxjerrjen e Projektligjit për Diasporën me qëllim të avancimit të kornizës ligjore për rregullimin e marrëdhënieve midis Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës. Por, për nga kronologjia e ngjarjeve, pothuajse 3 vite nga fillimi i mandatit, projektligji ende nuk është finalizuar. Gërvalla-Schwarz në takimin e parë po ashtu theksoi se diplomacia ekonomike dhe kulturore janë lënë pas dore duke theksuar rëndësinë e diasporës dhe investimeve të tyre në Kosovë. Sipas saj, defekti kryesor është që projektligji për diasporën është përgatitur në Kosovë pa biseduar nga afër me mërgatën për t’i pyetur ata rreth formës më të mirë të organizimit të tyre dhe pritshmërive që ata kanë ndaj institucioneve të Kosovës. Në takimin e komisionit një muaj më vonë, ish-kryetari i Komisionit deputeti Haki Abazi, ndër të tjerash thekson nevojën për ndryshimin e qasjes ndaj diasporës me qëllim që potenciali i diasporës të shihet tani e tutje si investitor në Kosovë.

Në takimet e radhës të Komisionit në nëntor të vitit 2021 diskutohen problemet rreth kushteve dhe kornizës ligjore për investime në Kosovë si dhe mungesa e një gjykate komerciale e cila do të shkurtonte drastikisht kohën e nevojshme për zgjidhjen e konteksteve gjyqësore të rasteve komerciale. Kjo çështje u ngrit nga Ambasadori Gjerman në Kosovë i cili ishte ftuar nga Komisioni. Fatmirësisht me përkrahjen e USAID gjykata komerciale është funksionalizuar që nga gushti i vitit 2022. Në fund të nëntorit ministrja me ftesë nga Komisioni raportoi për punën e saj si udhëheqëse e MPJD-së. Sërish diskutohet nevoja për rishikimin fundamental të Ligjit për Diasporën.

Për pothuajse një vit, në Komision nuk pati ndonjë diskutim substancial rreth çështjeve të diasporës. Më 25 nëntor 2022, Gërvalla-Schwarz raportoi para Komisionit ku thekson se përmes Ligjit të Diasporës do të mund të rregullohet mënyra e votimit si dhe çështja e mësimit plotësues të gjuhës shqipe – dy problematika kryesore të komunitetit shqiptar në diasporë. Po ashtu, Ministrja njoftoi komisionin për gatishmërinë e Maqedonisë së Veriut për të bashkëpunuar me Shqipërinë dhe Kosovën për shkolla të përbashkëta shqipe dhe bashkëfinancim të qendrave kulturore.

Në dhjetor të vitit 2022 MPJD raportoi në Komision rreth të arriturave dhe sfidave të vitit në fushën e politikës së jashtme dhe diasporës. Gërvalla-Schwarz identifikoi se çështja e mësimit të gjuhës shqipe në diasporë nuk ka shënuar asnjë rezultat konkret mirëpo theksoi që kjo do të jetë prioritet për diasporën për vitin 2023. Gjatë takimit një nga deputetet pyeti lidhur me Ligjin për Diasporën i cili ndonjëse ishte në planin legjislativ për vitin 2022, nuk doli në diskutim publik. Nga deputetet e Komisionit u propozua që qeveria të rregullojë tërheqjen e diasporës për investime kapitale përmes programeve në vend të strategjive si dhe mundësia që ambasadat e Kosovës nëpër botë të pajisen me atashe ekonomik të cilën do të kishin rol në intensifikimin e marrëdhënieve bilaterale rreth investimeve.

Raportimi i parë i Ministrës Gërvalla-Schwarz para Komisionit për vitin 2023 u mbajt më 7 prill. Sërish në takim u potencua që viti 2023 do të jetë viti i mësimit të gjuhës shqipe për fëmijët e mërgimtarëve. Sipas raportimit, MPJD po punon në një koncept që do të prezantohet në diasporë si dhe në strategjinë dhe ligjin e diasporës për të siguruar përfshirjen e mërgatës në jetën ekonomike, publike dhe sociale.

Në maj të vitit 2023, Komisioni Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë morri vendimin për organizimin e disa takimeve me diasporë në kuadër të punës së komisionit mirëpo nuk dihet se cilat ishin rezultatet nga diskutimet në diasporë apo ku u realizuan ato. Takimet e radhës të komisionit deri në fund të vitit 2023 vetëm shkarazi përmendin diasporën dhe problemet me mësimin e gjuhës shqipe.

Në nëntor kryetarja e komisionit njoftoi për ftesën për nënshkrim të memorandumit të bashkëpunimit për bashkërendim të çështjeve të diasporës në mes të komisionit, [GERMIN](#)-it dhe MPJD-së.

Në retrospektivë, mund të vërehet një qasje e shumënashme brenda Ministrisë për përfshirje të diasporës përmes fillimit të iniciativave si “Diplomacia Qytetare” apo “Shijo Kosovën”, takimeve në diasporë me komunitetin shqiptar në diasporë, bashkërendimit të çështjeve të diasporës me organizatat e tjera qeveritare dhe komunat etj. Këto iniciativa janë mbi të gjitha indikatorë të mirë që angazhimi i diasporës është vendosur në qendër të politikës së jashtme dhe të brendshme të qeverisë aktuale. Megjithatë, pavarësisht këtyre, sfidat e institucioneve kundrejt diasporës dhe sfidat e vetë diasporës janë të shumta. Këto sfida elaborohen në pjesën e mëposhtme të analizës:

## 4. Vlerësimi i sfidave dhe mundësive të diasporës kosovare

Kur fillon të mendohet rreth sfidave të komunitetit shqiptar në diasporë dhe përfshirjes së tyre në politikë bërje, problemi i parë lidhet me mungesën e të dhënave të besueshme rreth numrit të diasporës, shtrirjes dhe përbërjes së saj. Qeveria në rastin më të mirë mund të krijojë programe dhe politika për diasporën pa i kuptuar në të vërtetë nevojat reale të saj dhe në këtë mënyrë e minimizon mundësinë e përfitimit nga ky potencial dhe mobilizimin i diasporës. Për shembull, ende nuk dihet numri i saktë i diasporës i cili varësisht nga burimi sillet midis 700 mijë deri në 1 milionë. Por, ky numër për shkak të migrimit të vazhdueshëm në vitet e fundit është në rritje nga viti në vit. Të njëjtin mendim e ndan edhe zyrtari i intervistuar nga MPJD i cili thekson se mungesa e të dhënave është një nga handikapët kryesor të secilës qeveri qysh nga paslufta e sot. Sipas tij, numri zyrtar të cilin institucionet shtetërore i marrin nga vendet e ndryshme ku qytetarët e Kosovës jetojnë, është shumë i vogël meqë se p.sh në Gjermani regjistrohen vetëm personat të cilët kanë pasaportë të Kosovës, ndërsa eliminohen të gjitha kategoritë e tjera (Intervistë me H.R, komunikim personal, 10 janar 2024).

Përveç numrit të saktë të diasporës që në vetvete nuk është faktori më i rëndësishëm, problemi qëndron në mungesën e të dhënave rreth profilit të saj. Sipas njërit nga të intervistuarit, institucionet e Kosovës dhe Shqipërisë duhet të kenë kujdes që të mos e trajtojnë diasporën si një grup homogjen por të dizajnojnë plane dhe programe duke pasur parasysh profilin e diasporës (Intervistë me B.T, komunikim personal, 11 janar 2024). Po ashtu, institucionet kosovare duhet pasur parasysh kur draftojnë strategji dhe programe, që dallimet ekzistojnë edhe për nga mënyra e organizimit të brendshëm të diasporës varësisht nga vendi ku ata jetojnë.

Thënë këtë, diaspora e Kosovës po ndryshon vazhdimisht dhe në këtë mënyrë edhe mundësitë e saj për të ndihmuar në qëndrueshmëri ekonomike, llojllojshmërisë kulturore, politike, sociale dhe përtej. Një hap pozitiv në lidhje me të kuptuarit e numrit, gjendjes dhe nevojave të qytetarëve në diasporë MPJD-ja ka shënuar pas lancimi të platformës [e-Diaspora](#) në prill të vitit 2024 mbështetur nga Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ). Në bazë të të dhënave zyrtare platforma është e ngjashme me platformën ekzistuese [e-Kosova](#) ku lehtësisht pjesëtarët e diasporës mund të regjistrohen. Platforma synon që për herë të parë të hedh dritë mbi profilin profesional të pjesëtarëve të diasporës përmes regjistrimit. Sidoqoftë, nuk është e qartë nëse qytetarët në diasporë do të mund të regjistrohen edhe pas përfundimit të procesit të Regjistrimit të Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në kuadër të ASK-së, proces i cili finalizohet më 17 maj të vitit 2024. Nga burimet zyrtare kuptohet që MPJD në bashkëpunim me ministrinë e tjera përkatëse, është po ashtu në proces të krijimit të një databaze të veçantë të artistëve, sportistëve dhe personave të tjerë që merren me kulturë dhe një databazë tjetër për pjesëtarë të komunitetit të diasporës të cilët janë aktiv në politikë në vendet ku jetojnë dhe veprojnë. Ky është një lajm i mirë rreth mundësisë së rrjetëzimit dhe komunikimit të institucioneve shtetërore me grupe të caktuara të diasporës.

Në bazë të shqyrtimit të raporteve, proces-verbaleve, vendimeve të qeverisë etj. janë disa tema që vazhdimisht theksohen si sfidat kryesore me të cilat përballet diaspora dhe të cilat do të diskutohen mëposhtë. Gjëja e parë që na vjen në mendje kur e mendojmë potencialin e diasporës në Kosovën, me theks pas shpalljes së pavarësisë, është potenciali ekonomik i diasporës, i cili ende manifestohet kryesisht në formën e remitancave financiare.

## 4.1 Investimet dhe Diaspora

Sipas [Investopedisë](#), remitanca në kuptimin e thjeshtë është para e dërguar nga një palë tek tjetra, mirëpo koncepti në ditët e sotme nënkuptohet si shumë e parave e cila dërgohet nga dikush që punon jashtë vendit tek familja në vendin e tyre të origjinës. Tutje sipas investopedisë remitancat përfaqësojnë burimet më të mëdha të të ardhurave në vendet në zhvillim, duke ndihmuar në rritjen e standardit të jetesës për njerëzit në vende me të ardhura të ulta (Murphy, 2024). Edhe IOM përkufizon remitancat si transfere financiare që bëhen nga migrantët direkt tek familjet ose komunitetet e tyre në vendin e origjinës. Të dhënat nga raporti i fundit i IOM-it tregojnë për një rritje të përgjithshme të remitancave në nivel global në dekadat e fundit nga 126 miliardë dollar në vitin 2000 në 702 miliardë dollar në vitin 2020 (IOM, 2022). Po ashtu, përkundër parashikimeve Covid-19 nuk pati ndonjë ndikim në rënien e remitancave ashtu siç ishte parashikuar. Në fakt, në rastin e Kosovës, remitancat e dërguara nëpërmjet rrugëve formale u rritën dukshëm në kohën e pandemisë nga 15.8% e GDP-së në vitin 2019 në mbi 18% në vitin 2020 (World Bank, 2022).

Por, roli i remitancave në zhvillim e qëndrueshëm ekonomik të një vendi lë shumë për të dëshiruar. Sipas një studimi të Parlamentit Evropian: “Remitancat priren të reduktojnë varfërinë, megjithëse në mënyrë modeste, por ndikimi i tyre në pabarazi është i pabarabartë dhe ndonjëherë negativ. Në përgjithësi, aftësia e remitancave për të çuar përpara zhvillimin e qëndrueshëm është domosdoshmërisht e lidhur me politikën dhe mjedisin e investimeve” (European Parliament, 2022). Një realitet i tillë është edhe në Kosovë. Pra në mënyrë që remitancat të luajnë rol afatgjatë në zhvillimin ekonomik në Kosovë, qeveria në njërin anë duhet të ofrojë kushte dhe një mjedis të sigurt të investimeve ndërsa diaspora të ketë motivimin për investime afatgjata. Sipas raportit të Bankës Botërore të vitit 2023, ndonëse remitancat kanë efekt të përzier në zbutjen e pabarazisë, të gjeturat tregojnë që remitancat rrisin pabarazinë në Kosovë për dallim nga disa vende si Meksika dhe Pakistani ku vërehet e kundërta. Tutje, raporti thekson se efekti i remitancave varet nga familjet/ekonomitë familjare që i pranojnë ato dhe nga shuma e tyre (World Bank, 2023).


Sipas [Bankës Qëndrore të Kosovës \(BQK\)](#), vlera e remitancave në vend është rritur nga viti në vit, duke përbërë prurjen më të madhe financiare në ekonominë e Kosovës. Në vitin që sapo e lamë pas (2023), diaspora solli mbi 1.2 miliardë euro brenda një periudhe 11 mujorshe, apo 10% më shumë sesa një vit më parë. Prurjet më të mëdha ishin nga institucionet financiare jo-bankare (65%), bankat me 16% dhe kanalet e tjera me 19%. Sipas të dhënave nga BQK, pjesa më e madhe e remitancave shkon në konsum dhe në investime kryesisht të blerjes së patundshmërive (REL, 2023). Po ashtu duhet përmendur që remitancat reale të cilat janë shumë më të larta se sa ato që vinë përmes kanaleve zyrtare si dhe konsumi i diasporës gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë përbëjnë shtytjen më të madhe ekonomike për Kosovën. Kjo në vetvete është dëshmi e mjaftueshme se diaspora përbën asetin më të çmueshëm dhe kritik për zhvillim e qëndrueshëm të Kosovës. Studimet paraprake sugjerojnë që qeveria duhet të konsiderojë edhe uljen e kostove të transfereve financiare për remitanca ndërmjet rrugëve zyrtare apo informimin e qytetarëve në diasporë për metodat më pak të kushtueshme të dërgimit të parave të tyre në vendin e origjinës.

<sup>3</sup>Shih për shembull studimin e detajuar të Germin-it në lidhje me potencialin ekonomik të diasporës: <https://germin.org/wp-content/uploads/2024/01/Harnessing-the-Potential-of-the-Kosovar-Diasporas-Economic-Contributions-Research.pdf>

**Figura 1.** Vlera e remitancave ndër vite. Burimi: B

| Viti | Vlera e remitancave në euro |
|------|-----------------------------|
| 2015 | 665.6 milionë               |
| 2016 | 691.8 milionë               |
| 2017 | 759.2 milionë               |
| 2018 | 800.5 milionë               |
| 2019 | 851.7 milionë               |
| 2020 | 980.1 milionë               |
| 2021 | 1.153 miliardë              |
| 2022 | 1.228 miliardë              |
| 2023 | 1.344.5 miliardë            |

### Vlera e remitancave në euro 2015 - 2023



### **Figura 1.** Vlera e remitancave ndër vite. Burimi: Banka Qendrore e Kosovës

Duke ditur vështirësitë e qytetarëve të Kosovës për të mbuluar shpenzimet për strehim dhe banim, remitancat e diasporës mbesin shpresa e vetme për shume familje kosovare. Një anketë e realizuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) thekson se 78.5% e familjeve hasin vështirësi për të mbuluar shpenzimet e strehimit dhe banimit, madje 41% e tyre e kanë barrë të rëndë (Nacionale, 2022). Meqë Kosova prodhon pak dhe ka bilanc tregtar negativ ndikimi i remitancave në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik është edhe më i vogël. Sipas ekspertëve vendor të ekonomisë, paratë duhet të orientohen në prodhim dhe se Qeveritë duhet të draftojë programe ose strategji zhvillimore me qëllim të avancimit të investimeve nga diaspora (Rajoni Press, 2022) .

Sipas zyrtarit të intervistuar nga MPJD, deri në vitin 2017 diaspora është krahasuar ndryshe në kontekstin ekonomik krahasuar me pas vitit 2018. Kjo qasje sipas tij ka ardhur si rezultat i mungesës së investimeve të huaja direkte dhe pritshmëriëve të larta fillestare që pas pavarësisë vendin do ta vërshonin investimet e huaja (Intervistë me H.R, komunikim personal, 10 janar 2024). Meqë një gjë e tillë nuk ndodhi (investimet ranë drastikisht nga viti 2008 e tutje), orientimi është kthyer tek potenciali i pashfrytëzuar i diasporës dhe krijimi i kushteve adekuate për investim. Kjo duke u nisur nga fakti se përtej interesit ekonomiko-financiar, një nga arsyet kryesore përse diaspora mund të zgjedhë të investojë në Kosovë, është lidhja emocionale dhe vullneti për të kontribuar në komunitetin e tyre - ashtu siç tregojnë studimet paraprake të Germin të të njejtës temë.

Tema e potencialit ekonomik dhe investimeve nga diaspora është padyshim çështja dominuese në çdo diskutim rreth të ardhmes së diasporës kosovare. Edhe në intervistat e realizuara me pjesëtarë të komunitetit të diasporës ritheksohet mundësia e qeverisë për të bërë shumë më tepër rreth nxitjes së diasporës për investime për shkak të sfidave të shumta që ekzistojnë në lidhje me mundësinë për investime të huaja në Kosovë. Nga perspektiva e diasporës sfidat kryesore në lidhje më investimet janë si mëposhtë:



### 4.1.1 Mungesa e informimit dhe udhëzimit

Një nga barrierat fillestare të investimeve të diasporës në Kosovë lidhet me mungesën e informimit si pasojë të informatave të paqarta dhe gjithëpërfshirëse rreth procedurave administrative deri tek udhëzimi për sektorët potencial ku mund të investohet. P.sh, në bazë të një studimi nga Germin, diaspora e Kosovës nuk ka fare informata në lidhje me sistemin e taksave në Kosovë dhe procedurat administrative për të investuar në Kosovë (Germin, 2023). Çështja e informimit dhe udhëzimit ishte temë përsëritëse në secilën intervistë dhe në fokus grupet me diasporë, meqë konsiderohet si pikë startuese (“starting point”) për nxitjen e investimeve apo dekurajimin e investimeve në rastin më të keq duke u nisur nga premisa që diaspora ka vullnet për të investuar në Kosovë.

Sigurisht, kjo nuk do të thotë që informata nuk ekzistojnë askund. Problemi qëndron tek kanalizimi i tyre deri tek diaspora nëpërmjet kanaleve zyrtare, platformave apo masmedias. Në kuadër të qeverisë së Kosovës ekziston Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) e cila ka funksionin kryesor në promovimin dhe mbështetjen e investimeve në Kosovë. Krahas KIESA-s, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Ministria e Ekonomisë (ME), dhe komunat ofrojnë një platformë të mirë për të marrë informata. Duke ditur rëndësinë e komunave që për shumicën e pjesëtarëve të diasporës është dera e parë e komunikimit me institucionet e shtetit, me kërkesë të MPJD-së tashmë është formuar kolegji i komunave, ku çdo komunë obligohet që të caktojë nga një zyrtar të veçantë për diasporë. Nga informatat e marra, deri më tani ky bashkëpunim i parë midis nivelit qendror dhe atij lokal për diasporë ka qenë në aspektin kulturor ndërsa pritshmëritë janë që ky bashkëpunim të shtrihet në të ardhmen edhe në aspektin ekonomik.

Një studim i realizuar nga Germin me qëllim të analizimit të potencialit financiar të diasporës për investime nxjerr në pah arsyet kryesore që pengojnë investimet e diasporës. Ndër to, opsionet më të spikatura ishin pikërisht mjedisi i pasigurt për investime, korrupsioni dhe mungesa e sundimit të ligjit si arsyet kryesore për të mos investuar në Kosovë (2023). Thënë këto, qeveria e Kosovës duhet të eksplorojë forma të tjera të inkurajimit të diasporës në investime siç është për shembull statusi i veçantë që mund të përfshijë trajtimin preferencial në procedura administrative, incentiva në taksa etj. Një tjetër mundësi është ofrimi i mekanizmave të cilat mbrojnë dhe garantojnë investimet e diasporës në formën e garancive të investimeve të sponsorizuara publikisht. Këto mekanizma përdoren nga shumë qeveri në vende të ndryshme për të promovuar dhe mbrojtur investitorët strategjik në vendin e tyre dhe sipas të anketuarve në studim, do të rrisnin në masë të madhe gjasat e tyre për të investuar në Kosovë.

### 4.1.2 Pasiguria politike dhe juridike

Nuk do shumë mend që përmbledhet ideja se pa stabilitet politik nuk ka zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Këta dy indikatorë janë të lidhur ngushtë me njëri tjetrin. Mungesa e stabilitetit politik automatikisht dekurajon investimet nga jashtë çfarë qon në ngadalësim të zhvillimit ekonomik dhe njëkohësisht mungesa e zhvillimit ekonomik shkakton pakënaqësi dhe mungesë të besimit në qeveri dhe institucione në përgjithësi. Fatkeqësisht Kosova nuk ka pasur një klimë të përshtatshme politike dhe juridike/ligjore për të stimuluar investimet e huaja qoftë nga diaspora apo investitorët e tjerë me origjinë jo-shqiptare.

Ndryshimet dhe ngërçet e shpeshta politike, duket qartë se e kanë dhënë rezultatin e tyre negativ në promovimin e investimeve. Këto vonesa kanë ngadalësuar edhe përmirësimin e kornizës ligjore e cila do të krijonte bazamentin normativ për inkurajimin e investimeve për shembull përmes trajtimit preferencial të investitorëve. Gjatë intervistave u ndanë madje edhe shembuj të hidhur të rasteve kur investitorë të huaj përkundër dëshirës së tyre për të investuar në Kosovë, u detyruan të lëvizin në vendet e tjera fqinje të Ballkanit Perëndimor për shkak të ofrimit të kushteve më të mira dhe lehtësimit të procedurave ligjore dhe administrative. Në këtë aspekt qeveria dhe shteti i Kosovës kanë ngecje të mëdha. Meqë potenciali më i madh ekonomik tashmë ka kaluar në gjeneratën e dytë dhe të tretë të diasporës të cilët janë shumë më mirë të integruar në vendet ku jetojnë, shkollohen dhe veprojnë. Pa një kornizë të qartë dhe efikase ligjore nuk mund të paramendohet një fluks i investimeve afatgjata nga diaspora. Procedurat e ndërlikuara administrative dhe burokratike edhe me tepër vështirësojnë këtë.

### **4.1.3 Mungesa e sundimit të ligjit**

Një nga pasojat që prodhon pasiguria politike dhe juridike është mungesa e sundimit të ligjit që në vetvete prodhon korrupsion në formë të ryshfetit dhe konkurrencës jofer. Kjo më tutje shton hezitimin e diasporës për të investuar në vendin amë. Një gjë u theksua edhe gjatë fokus grupit të diasporës nga njohës të çështjeve ligjore të cilët shprehin shqetësimet e tyre rreth mos efikasitetit të Autoritetit për Konkurrencën gjegjësisht Ligjit Nr.08/L-056 për mbrojtjen e Konkurrencës; dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi e cila është përgjegjëse për mbikëqyrjen e ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit Nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Pjesëmarrësit shprehin shqetësimin e tyre rreth ambientit konkurrues në Kosovë i cili fatkeqësisht nuk arrin të mbrojë kompanitë e vogla nga konkurrenca e paligjshme dhe shqetësimet rreth mbrojtjes së të dhënave personale të konsumatorëve.

Përveç arsyeve të lartpërmendura, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë që ndikojnë negativisht në dëshirën e diasporës për të bërë investime në Kosovë, të cilëve çdo qeveri e Kosovës duhet t'u japë vëmendje të veçantë. Ndër këto faktorë, veçohet mungesa e një fuqie punëtore të kualifikuar, pavarësisht se Kosova zotëron një fuqi punëtore të re dhe entuziaste, si dhe infrastruktura e dobët dhe joadekuate, për shembull, problemet me energjinë elektrike apo shërbimet tjera publike që janë thelbësore për funksionimin e çdo lloj biznesi.

## **4.2 Mësimi plotësues në gjuhën shqipe në diasporë**

Përpos sfidave që lidhen me potencialin ekonomik të diasporës, një temë mbizotëruese kur flitet për diasporë është çështja e mësimi plotësues në gjuhën shqipe. Kjo është e qartë jo vetëm nga perspektiva e diasporës por edhe nga raportimet e MPJD-së në KPPJD ku në fillim të çdo viti kalendarik u premtua se viti përkatës do të jetë vit i mësimi shqip në diasporë. Në bazë të planit të punës të MPJD-së për vitin 2024, çështja e mësimi plotësues në diasporë mbetet çështje me prioritet. Megjithatë, realiteti në terren është ndryshe.

Ndonëse çështja e mësimi plotësues është trajtuar qysh para luftës së fundit në Kosovë, organizimi i mësimi plotësues nuk është institucionalizuar asnjëherë. Këtë e ka vështirësuar padyshim edhe mungesa e bashkëpunimit midis tri shteteve prej nga e kanë origjinën diaspora shqiptare në diasporë, gjegjësisht:

Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Sipas përlogaritjeve të MPJD-së financimi i mësim shqip në diasporë do të kushtonte diku prej 13 deri në 15 milionë euro në vit dhe që ekziston një koncept dokument brenda Ministrisë i cili i është prezantuar kabinetit të ministres. Pritet që Ministria të marrë edhe një iniciative për thirrjen e grupit punues për rishqyrtimin e draftit final. Sipas zyrtarit të MPJD-së, koncept dokumenti parasheh tre skenarë të mundshme për formën e ofrimit të mësim plotësues në diasporë:

Skenari 1: Mirëmbahet gjendja aktuale (status quo) ku qeveria e Kosovës furnizon me libra për nivelin e parë, dytë dhe tretë (ky opsion nuk është i kënaqshëm meqë numri i të interesuarve për mësim plotësues është shumë i ulët);

Skenari 2: Pagesat alternative për mësimin plotësues ndahen ndërmjet prindërve dhe shoqatave;

Skenari 3: Qeveria e Kosovës merr plotësisht përsipër që të organizojë mësimin plotësues në diasporë dhe të nënshkruajë marrëveshje bilaterale me shtetet pritëse aty ku është e mundshme. Sipas MPJD-së, shtetet të cilat aktualisht ofrojnë mësimin plotësues në shqip janë Austria, Suedia dhe Republika Gjermane e Baden-Wurtembergu. Së fundmi edhe Senati i Berlinit morri vendimin për ofrimin e gjuhës shqipe në çdo shkollë ku interesimi për mësim plotësues dëshmohej përmes formularëve nga minimumi 12 nxënës shqiptarë.

Përtej sfidave institucionale dhe mungesës së koordinimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, sfida tjetër është interesimi shumë i ulët për mësim plotësues në gjuhën shqipe përkundër faktit që numri i diasporës është vazhdimisht në rritje. Kjo paraqet një rrezik tepër të madh për vetë ruajtjen e identitetit shqiptar tek komuniteti në diasporë, i cili rrezikohet jo vetëm nga integrimi i diasporës në vendet përkatëse por mbi të gjitha nga globalizmi. Prandaj, problematika që duhet adresuar nuk është vetëm organizimi i mësim të gjuhës shqipe jashtë vendit, por edhe si ky proces do të bëhet tërheqës për diasporën.

Pa e ushqyer ndjenjën e përkatësisë kombëtare vështirë të paramendohet rritja e interesimit për të mësuar më shumë për gjuhën dhe kulturën shqiptare dhe rrjedhimisht të forcohet ndjenja e përkatësisë kombëtare. Kjo ndjenjë mund të forcohet përmes ekspozimit të diasporës, sidomos gjeneratave të reja, ndaj historisë, gjuhës dhe kulturës shqiptare. Në këtë aspekt inkurajohen sa më shumë programe shkëmbimi të të rinjve nga diaspora në Kosovë dhe Shqipëri siç është shembulli i programit “OriginAL”, burime të gjuhës shqipe online, aplikacione për mësimin e gjuhës shqipe, etj. Gjatë kohës së qëndrimit të diasporës në Kosovë sidomos në periudhën e verës inkurajohen që të promovohen sa më shumë programet dhe eventet kulturore me fokus tek e kaluara, kultura dhe identiteti shqiptar. Po ashtu inkurajohet rrjetëzimi ndërmjet të rinjve në Kosovë dhe Shqipëri me ata në diasporë si forma më e mirë e krijimit të lidhjeve emocionale me vendet e origjinës meqë me kalimin e kohës, ekziston rreziku i madh i dobësimit të lidhjes emocionale të gjeneratave të reja në diasporë me Kosovën.

Përtej përgjegjësisë institucionale për të ofruar kushtet, prindërit në diasporë duhen inkurajuar dhe vetëdijesuar për të dërguar fëmijët e tyre që të ndjekin mësim plotësues në shqip aty ku ofrohet konform kornizave ligjore të vendit përkatës. P.sh një nga të intervistuarit është i mendimit që diaspora duhet të ketë organizim më serioz rreth vetëdijesimit të prindërve për rëndësinë e mësim të gjuhës shqipe dhe se qeveria ka bërë mjaft në këtë drejtim. “Nuk është përgjegjësi e ambasadës apo e shtetit të Kosovës që t’i bind prindërit ti dërgojnë fëmijët në mësim plotësues në gjuhën shqipe” (Intervistë me B.T,

komunikim personal, 11 janar 2024). Përveç mungesës së koordinimit institucional ndërmjet Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, numrit të ulët të interesimit për mësim plotësues në gjuhën shqipe një problem përcjellës ka të bëjë me mungesën e çertifikimit të gjuhës shqipe duke e pamundësuar klasifikimin e njohurive në bazë të niveleve ashtu siç ekziston për gjuhët e tjera (A1-C2) dhe mungesën serioze të mësuesve të kualifikuar të gjuhës shqipe.

Mësimi plotësues në diasporë po ashtu mbizotëroi si temë në diskutimet me komunitetin e diasporës në Gjermani dhe intervistat me pjesëtarë të diasporës. Sipas tyre, mësuesit mund të kenë rol më aktiv në sensibilizimin e prindërve për rëndësinë e mësimi plotësues në shqip dhe si të tillë duhet të kenë më shumë mbështetje nga ambasadat/konsultat e vendeve ku veprojnë. Kësaj kauzë do të mund t'i ndihmonte ngritja e qendrave kulturore shqiptare apo edhe instituteve shtetërore të cilat do të kishin rol kryesor në promovimin e identitetit dhe kulturës shqiptare ku përfshihet mbi të gjitha gjuha si elementi unifikues i një kombi. Përpos qendrave kulturore të cilat mund të mos jenë atraktive për gjeneratat e reja, qeveria së bashku me ambasadat duhet të angazhohet për më shumë projekte mediatike të cilat do të arrinin tek diaspora me lehtësi dhe të ndihmonin në përmirësimin e gjendjes aktuale.

### **4.3 Mungesa e qendrave kulturore në diasporë**

Një nga mënyrat më efikase për të forcuar ndjenjën e përkatësisë dhe ruajtur identitetin në diasporë është përmes funksionalizimit të qendrave kulturore. Duke pas parasysh që diaspora nga Kosova nuk është e organizuar në mënyrë të mirëfilltë, përmes qendrave kulturore do të mund të krijoheshin ura të reja të komunikimit dhe rrjetëzimit në mes të profesionistëve dhe qytetarëve kosovarë në diasporë. Poashtu, përveç organizimit të brendshëm, qendrat kulturore mund të luajnë rol kyq në fuqizimin e lidhjes midis vendit amë që ato përfaqësojnë dhe vendit ku ato themelohen. Për një shtet relativisht të ri si Kosova, me resurse të kufizuara diplomatike, qendrat kulturore mund të ndihmojnë drejtëpërdrejtë në fuqizimin e të ashtuquajturës diplomaci të butë.

Sipas legjisllacionit në fuqi, aktualisht ekzistojnë tre qendra kulturore (QKD) në Suedi, Zvicër dhe Turqi, ndonëse organizimi i tyre pritet të ndryshoj me projekligjin e ri për diasporën. Me projektligjin i cili ishte në shqyrtim në vitin 2019 ishin paraparë edhe ndryshime substanciale në formën e rregullimit të funksionalizimit të qendrave kulturore në diasporë. P.sh propozimi i atëhershëm i ligjit parashihte që drejtori i QKD-së të kishte titullin e atashut të Republikës së Kosovës dhe që hapja e tyre të bëhej përmes marrëveshjeve bilaterale me shtetet të cilat kanë interesa të përbashkëta me vendin tonë. Sidoqoftë, situata tani për tani është e paqartë sa i përket vizionit, statusit legal, strukturës organizative apo financimit të QKD-ve në të ardhmen.

Kosova mund të nxjerrë mësim të vlefshme nga shtete të tjera me të kaluar apo kontekst të ngjashëm sa i përket organizimit të diasporës përmes funksionalizimit të qendrave kulturore dhe jo vetëm. Sipas raportit të Germin (2019, dokument i brendshëm), në rastin e Kosovës, aktualisht QKD-të paraqiten si mekanizëm i shtetit për komunitetin dhe jo si mekanizëm ndër-veprues i komunitetit i mbështetur nga shteti. Shtete të ndryshme prej të cilave Kosova mund të mësojë, i kanë të rregulluar ndryshe këto elemente. Për shembull, Irlanda i mbështet qendrat kulturore përmes programit për mbështetjen e emigrantëve (Emigrant Support Programme), për të cilën vetëm në vitin 2018 shpenzoi 11.6 milionë euro. Këto qendra kulturore kanë statusin legal të organizatave jo-qeveritare, asociacioneve apo

fondacioneve, mirëpo nuk drejtohen apo menaxhohen nga qeveria por nga komunitetet irlandeze në diasporë. Rasti i njejtë është edhe në Armeni ku qendrat kulturore janë të themeluara dhe të organizuara nga vetë komuniteti armen në diasporë. Në Izrael ekziston Agjencia Hebraike për Izraelin si organizate globale kulturore në kaudër të së cilës funksionojnë edhe QKD-të si organizata ndërqeveritare por nuk financohen nga paratë publike të Izraelit.

Në këtë aspekt, MPJD përfundimisht duhet të shtyejë përpara procesin e rregullimit ligjor për funksionalizimin dhe themelimin e qendrave kulturore në dobi të komunitetit dhe si elemente bashkëvepruese. Tutje, MPJD duke pasur parasysh dallimet që ekzistojnë ndërmjet komuniteteve jashtë Kosovës varësisht nga vendi ku jetojnë. Germin rekomandon që QKD-të duhet të trajtohen si organizma kyç për promovimin e interesit shtetëror dhe kombëtar mirëpo duhet që ato të lihen në diskrecion mekanizmave jo-qeveritar. Përgjithësisht bën faza fillestare e themelimit dhe financimit ku qeveria duhet të ofrojë mbështetje maksimale.

#### 4.4 Votimi në diasporë

Krahas potencialit ekonomik, problemet me mësimin e gjuhës shqipe dhe mungesën e qendrave kulturore në diasporë, një sfidë tjetër e cila vazhdon të jetë temë e “nxehtë” në politikën kosovare është çështja e votimit të diasporës. Votimi jashtë vendit është e drejtë themelore e garantuar me ligj për secilin qytetar të Kosovës me dokumente valide sipas procedurave dhe afateve kohore të përcaktuara nga ligji për zgjedhje. E drejta e votës mbetet një nga format kyçe të pjesëmarrjes politike të qytetarëve brenda dhe jashtë vendit por në rastin e votuesve jashtë Kosovës ajo mund të shërbejë edhe si mekanizëm për ta mbajtur diasporën të lidhur me vendin amë (Venice Commission, 2011). Fillimisht, numri total i votuesve të cilët janë të pajisur me dokumente të Republikës së Kosovës llogaritet të jetë diku midis 400.000 deri në 600.000, mirëpo numri i votuesve nga diaspora tradicionalisht ka qenë shumë i ulët, duke lënë të nënkuptojmë që vetëm një pakicë e qytetarëve kosovarë në diasporë kanë interesim apo vullnet të përfshihen në proceset zgjedhore (Germin 2021). Sidoqoftë, një trend pozitiv është vërejtur në zgjedhjet e fundit nacionale të vitit 2021. Këtë mund ta shohim nga tabela e mëposhtme e cila paraqet numrin e aplikimeve për të votuar nga diaspora në zgjedhjet nacionale nga viti 2010 deri më 2021 (pesë raste të votimit).

|                                 | 2010       | 2014                     | 2017       | 2019        | 2021         |
|---------------------------------|------------|--------------------------|------------|-------------|--------------|
| Numri i aplikimeve të pranuar   | 5015       | 29745                    | 20354      | 40,313      | 130,016      |
| Numri i aplikimeve të aprovuara | 1640 (32%) | 16569 (55%) <sup>1</sup> | 5118 (74%) | 35087 (87%) | 102467 (78%) |

**Fig.2** Numri i aplikimeve të pranuar dhe të aprovuara në pesë raundet e zgjedhjeve nga 2010-2021. Burimi: Përshtatur nga Germin (2021).

Pra krahasuar me vitin 2010, numri i aplikimeve nga diaspora është pothuajse 25 herë më i lartë në vitin 2021 dhe përqindja e aplikimeve të pranuar po ashtu është rritur ndër vite. Por aftësia e diasporës për të votuar në zgjedhjet qendrore apo ato lokale karakterizohet më një sërë problemesh politike, ligjore dhe logjistike të cilat mund të grupohen si mëposhtë:

- a) Mungesa e dokumenteve valide të identifikimit si parakusht për t'u regjistruar dhe votuar në zgjedhjet e Kosovës. Kjo bëhet problematike sidomos kur ka zgjedhje të parakohshme të cilat në Kosovë janë më shumë normë sesa përjashtim dhe lidhet ngushtë me problemin e ngjashëm që ka të bëjë me afatet e shkurtra për regjistrim.
- b) Mungesa e informatave rreth të drejtave politike dhe formës së ushtrimit të kësaj të drejte. Si pasojë e mos informimit dhe procedurave të ndërlikuara për të votuar, shume qytetarë dekurajohen për të votuar.
- c) Votat e votuesve në diasporë tradicionalisht janë konsideruar si më pak të rëndësishme apo vota të dorës së dytë.
- d) Kostot e larta të votimit nga jashtë të cilat deri më tani janë bartur nga vetë qytetarët. Kostot lidhen kryesisht me shërbimet postare për të dërguar formularët e votimit në Qendrat e Numërimit të Votave. Përkundër kësaj një numër i madh i këtyre votave si shkak i keqinformimit, shpallen të pavlefshme duke dekurajuar edhe më shume votuesit jashtë vendit.
- e) Kërkesa ad-hoc shpesh banale siç ishte rasti i zgjedhjeve të fundit me kërkesën për verifikimin e votuesve në diasporë përmes numrave të tyre të telefonit. Kjo metodë lëre se shtoi koston financiare të organizimit të zgjedhjeve në njërën anë, por dëmtoi rëndë besueshmërinë tek institucionet shtetërore nga votuesit nga jashtë në anën tjetër.

Të gjitha këto sfida të lidhura ngushtë me njëra tjetrën kanë pasojat direkte në dekurajimin e votuesve jashtë vendit për të votuar. Duke pas parasysh mungesën e kulturës politike duhet që t'i kushtohet një rëndësi e veçantë lehtësimit të pengesave ligjore, burokratike dhe financiare për votuesit jashtë vendit. Në këtë aspekt, ndryshimi më i madh erdhi me votimin e [Ligjit të ri për Zgjedhje](#) (Ligji Nr. 08/L-228, 2023) i cili për herë të parë parasheh mundësinë e votimit fizik të diasporës në misione diplomatike apo dërgimit të fletëvotimit me postë tek misioni diplomatik i vendit përkatës. Ligji i ri në pjesën e përkufizimeve përmend përfaqësinë diplomatike e cila përveç që përfaqëson Republikës e Kosovën në një shtet tjetër, sipas ligjit në ditën e votimit mund të shfrytëzohet si qendër e votimit pas vlerësimit të KQZ-së në bashkëpunim me MPJD-në. Ligji përmban një kapitull të veçantë (Kapitulli XIV) për votimin jashtë vendit i cili sjell risi dhe inkorporon për herë të parë rekomandimet e shumë palëve të interesit përfshirë këtu edhe Germin si organizatë e cila ka bërë vazhdimisht thirrje për ndryshimin e këtij ligji dhe lehtësimit të procedurave të votimit për qytetarët e Kosovës jashtë vendit.

Më saktësisht, Ligji parasheh tri mënyra të votimit për qytetarët jashtë vendit në momentin e regjistrimit në platformën e KQZ-së:

1. Në formë fizike direkt në përfaqësitë diplomatike të cilat me aprovimin e KQZ-së kthehen në qendra të votimit. Kjo formë e votimit vlen vetëm për zgjedhjet nacionale dhe jo ato lokale. Sipas ligjit, votimi nëpër përfaqësi diplomatike do të organizohet një ditë para ditës së zgjedhjeve në Kosovë duke filluar nga ora 07 deri në ora 19 të mbrëmjes.
2. Dërgimi i fletëvotimeve përmes kutisë postare të KQZ-së në postën e Kosovës, si model i cili është përdorur deri tani dhe është përcjellë me mjaft problematika; dhe
3. Dërgimi i fletëvotimeve në kutitë postare të hapura nga KQZ-ja me lehtësimin e misioneve diplomatike, jashtë Kosovës.

Përveç dispozitave të përgjithshme rreth organizimit të votimit jashtë vendit, ligji rregullon edhe

mënyrën e aplikimit për fletëvotim ku secili shtetas i Kosovës që jeton jashtë vendit mund të plotësojë formularin e aplikimit për regjistrim përmes platformës elektronike e cila bën verifikimin e aplikuesit dhe përmes postës në një nga kutitë postare të KQZ-së. Tutje ligji përcakton që regjistrimi i votuesve përmes e-mail-it personal (siç ka qenë praktikë deri në zgjedhjet e fundit) mund të pranohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur regjistrimi në një nga format e lartpërmendura dështon për arsye objektive. Ndonëse këto amendamente janë jashtëzakonisht pozitive, mbetet të shihet se si do t'i menaxhoje këto ndryshime KQZ-ja në bashkëpunim me MPJD-në në zgjedhjet e ardhshme nacionale. Sfida aktuale mbetet informimi në kohë i qytetarëve në diasporë rreth implikimeve praktike të ligjit të ri.

## 4.5 Sfida të tjera

Përveç sfidave të elaboruara më sipër, ekzistojnë gjithashtu barrierat që lidhen kryesisht me problemet burokratike/administrative, të cilat kërkojnë angazhimin dhe vëmendjes të institucioneve. Mes tyre përfshihen: problemi i kartonit të gjelbër, çështjet e pensioneve, njohja e Kosovës si vend origjine nga vendet e tjera, procedurat komplekse dhe të zgjata për lëshimin e dokumenteve, mungesa e programeve informative për diasporën, apo edhe deri tek pakënaqësitë rreth çmimeve të larta të biletave gjatë periudhave me fluks sezonal, të cilat shpeshherë janë më të larta se çmimet e udhëtimeve transatlantike.

### 4.5.1 Kartoni i Gjelbër

Problemi i Kartonit të Gjelbër për diasporën kosovare vazhdon të jetë një sfidë që prej themelimit të Byrosë Kosovare të Sigurimeve (BKS) në vitin 2011, në përputhje me ligjin për Sigurimin e Detyrueshëm Automobilistik. Kartoni i Gjelbër është çertifikatë ndërkombëtare e sigurimit që mbulon dëmet nga aksidentet rrugore dhe është i nevojshëm në shtetet anëtare të Këshillit të Byrosë Evropiane të Sigurimeve. Kosova ende nuk është pjesë e këtij këshilli dhe si pasojë e kësaj obligon pronarët e automjeteve me targa të huaja të paguajnë sigurim shtesë - deri në 15 euro për një qëndrim 15-ditor.

Edhe pse qeveritë e ndryshme që kanë qenë në pushtet në Kosovë që nga viti 2011 kanë premtuar të adresojnë këtë çështje, ende nuk është gjetur një zgjidhje për të bërë Kosovën anëtare të Byrosë së Sigurimeve të Europës, pavarësisht se BKS pretendon se janë përmbushur kriteret financiare. Kjo situatë shkakton ndjenjë diskriminimi dhe pakënaqësi tek diaspora, të cilët e konsiderojnë këtë më shumë si një çështje të neglizhencës së institucioneve kosovare sesa si një pengesë politike të pakapërcyeshme. Për shembull, në një diskutim virtual të organizuar nga Germin në vitin 2017 me pjesëmarrës nga diaspora, u vërejt një pakënaqësi e madhe për këtë tarifë dhe arsyen e saj (Kusari, 2017). Kjo pagesë e rrit ndjenjën e mosbesimit ndaj institucioneve shtetërore, duke marrë parasysh që shuma të mëdha përfundojnë në xhepat e kompanive private të sigurimit. Të njëjtat mendime ndanë edhe të intervistuarit për qëllimin e kësaj analize dhe pjesëmarrësit në diskutimet me diasporën.

Adresimi dhe rregullimi i kësaj çështje do të kishte një impakt pozitiv në besimin e diasporës ndaj institucioneve kosovare, duke konsideruar kontributin financiar që mërgimtarët japin çdo vit në Kosovë. Meqë anëtarësimi direkt në Byronë e Sigurimeve të Europës është i pamundur (për shkak të kriterit politik për të qenë anëtare e OKB-së), Kosova duhet të shqyrtojë forma alternative ose marrëveshje bilaterale me shtetet ku ka një koncentrim të lartë të diasporës për të zgjidhur këtë pengesë sa më parë.


## 4.5.2 Pensionet

Një çështje e cila u shndërrua në krye teme në prill të vitit 2010 ishte tema e pensioneve të kosovarëve të cilët ishin kthyer nga Zvicra në Kosovë pas pensionimit. Kjo pasi Zvicra shkëputi në mënyre të njëanshme marrëveshjen sociale me Kosovën duke konsideruar që Kosova nuk i kishte strukturat përkatëse shtetërore, përkatësisht administratë funksionale për bashkëpunim duke përfshirë hetimet kundër dyshimeve për mashtrime dhe keqpërdorim të pensioneve. Si pasojë e këtij vendimi pensionistët që vendosën të ktheheshin nga Zvicra për të jetuar në Kosovë nuk gëzuan asnjë pagesë sociale nga Zvicra ndonëse kishin kontribuar me vite në arkat sociale të Zvicrës. Pas viteve të tëra negocimi, në vitin 2017 u arrit teksti final i marrëveshjes së re për Sigurime Sociale ndërsa kjo marrëveshje hyri në fuqi në shtator të vitit 2019. Sidoqoftë, problemi kryesor mbetet fakti që marrëveshja dhe vendimi i ri për pensionet nuk është retroaktiv.

Si pasojë e kësaj, qindra mijëra kosovarë që kanë vendosur të kthehen në vendlindje nga marsi i vitit 2010 deri në hyrjen në fuqi të marrëveshjes së re nuk mund të marrin pensionet e tyre. Sipas njohësve të çështjes, Kosova nuk ka krijuar kushtet për t'u siguruar që vendimi të jetë retroaktiv.

## 4.5.3 Njohja e Kosovës si vend i origjinës

Qytetarët kosovarë në disa shtete të Gjermanisë përballën më një pengesë administrative që nga shpallja e pavarësisë të Kosovës. Nga diskutimi me diasporën në Gjermani rezulton se për qytetarët e Kosovës të lindur para kësaj periudhe në çertifikatat e tyre të lindjes krahas shtetësisë së Kosovës dhe asaj gjermane listohet edhe nënshtetësia serbe, ndonëse kanë të dy prindërit kosovarë. Pra fëmijëve të kosovarëve, u figuron se janë shtetas të Serbisë deri në moshën e 16 vjeçare kur ata mund të zgjedhin se cila shtetësi duan t'u figurojë në çertifikatat e lindjes. Për këtë u raportua edhe vitin e kaluar nga mediat lokale si një nga problemet me të cilat përballlet diaspora në Gjermani, më saktësisht në landin e Baden-Wurtembergut dhe atë të Bayernit. Sipas konsullatës në Shtutgart, secila qeveri e cila ka udhëhequr MPJD-në ka qenë e informuar rreth problemit mirëpo ka qendruar e heshtur përballë tij (Klan Kosova, 2023). Institucionet e Kosovës duhet të identifikojnë edhe raste të tjera ku ndodh kjo dhe të kërkojnë sa më shpejtë adresimin e këtij shqetësimi.





## 5. Aspekte krahasuese të strategjive të suksesshme të diasporës

Shumë shtete në botë me numër të konsiderueshëm të diasporës, përballen më sfida të ngjashme me të cilat përballen diaspora e Kosovës. Por përveç sfidave, shtete të ndryshme paraqesin raste të suksesit prej të cilave Kosova mund të nxjerr mësim në qasjen e vet ndaj diasporës. Në pjesën e mëposhtme trajtojmë disa raste studimore të shteteve të cilat kanë implementuar strategji të ndryshme të angazhimit të diasporës, me qëllim të nxjerrjes së mësimave për kontekstin tonë. Për krahasim kemi marrë Moldavinë si shembull suksesi për remitanca, Shqipërinë për çështjen e mësimit shqip në diasporë, Kroacinë për përfaqësimin politik dhe Izraelin për diplomacinë e diasporës.

### 5.1 Moldavia

Siç e pamë nga përshkrimi më lartë, remitancat mbesin katalizatori më i fuqishëm i ekonomisë kosovare, ndërsa transformimi i këtyre remitancave në zhvillim afatgjatë ekonomik mbetet sfida për Kosovën. Ngjashëm me Kosovën, Moldavia konsiderohet si një nga shtetet me varësinë më të madhe nga remitancat në Evropë. Sipas përlogaritjeve, mbi 1 milionë qytetarë varen nga remitancat të cilat përbejnë mbi 50% të të hyrave të tyre dhe remitancat përbejnë diku rreth 16% të GDP-së së Moldavisë (World Bank, 2022). Kjo varësi dukshëm u hetua në kulmin e pandemisë COVID e cila goditi më së shumti sektorin e bujqësisë, pra qytetarët në zonat rurale të cilën varën kryekëput nga remitancat e familjarëve të cilët jetojnë jashtë vendit. Përveç rënies së fluksit të remitancave gjatë pandemisë, një sfidë tjetër në Moldavi janë vështirësitë për qasjen në remitanca për shkak të koncentrimit të institucioneve financiare në qendrat e mëdha urbane (United Nations Network on Migration, 2019). Pra, për qytetarët të cilët banojnë në zonat rurale dhe sidomos ata të përfshirë në bujqësi, rruga deri tek qasja e remitancave shpesh kushton kohë dhe para, duke përbërë një pengesë shtesë të panevojshme të cilët jo gjithkush mund ta përballojë. Për ta luftuar këtë dukuri, Fondi Ndërkombëtar për Zhvillim të Bujqësisë, në partneritetit me Komisionin Kombëtar të Moldavisë për Tregje Financiare kanë implementuar me sukses projektin që ka për qëllim menaxhimin e transfereve të remitancave përmes Asociacioneve të Kursimeve dhe Kredive (SCAs)-institucione financiare të shërbimeve bazë të pranishme edhe në zonat rurale (IFAD, 2021). Qëllimi i projektit është që remitancat të kanalizohen përmes këtyre institucioneve që përveç se të lehtësohet qasja në remitanca sa më afër qytetarit, po ashtu të inkurajohet dhe këshillohet kursimi i një pjesë të remitancave për aktivitete që gjenerojnë të ardhura dhe investime afatgjate. Por më e rëndësishmja, për të mbështetur bujqit dhe fermerët, përmes këtij projekti, SCA-të për herë të pare pranojnë remitancat e pranuar si kolateral i besueshëm në mënyrë që fermerët të kenë garancën e kërkuar për të marrë kredi për biznese. Po ashtu këto institucione me mbështetjen e qeverisë ofrojnë norma të interesit më të ulta për individët apo bizneset e përfshirë në bujqësi.

### 5.2 Kroacia

Republika e Kroacisë i kushton një rëndësi të madhe diasporës e cila sipas vlerësimeve zyrtare nga [Zyra Qëndrore Shtetërore për Kroatët](#) jashtë vendit konsiderohet se kalon mbi 2.5 milionë në gjithë botën. Diaspora Kroate në numër të madh jeton në Amerikën Veriore dhe Jugore, Australi, Zelandë të Re dhe Evropë (Gjermani, Austri, Itali etj). Në faqën zyrtare të kësaj zyreje përveç informatave të detajuara rreth përbërjes së diasporës, infomata të vyeshme për ta, thirrje publike etj, kroatët që jetojnë jashtë vendit mund të mësojnë gjuhën kroate online përmes kurseve A1 dhe A2, apo të aplikojnë për

bursa për të mësuar gjuhën kroate në Republikën e Kroacisë. Mbi të gjitha, Kosova mund të mësojë shumë nga Kroacia kur vjen puna tek përfaqësimi politik i diasporës në politik-bërjen kroate e cila ashtu siç specifikohet nga ligji elektoral në Kroaci garanton deri në 3 vende për përfaqësuesit e diasporës kroate. Përmes kësaj dispozite diaspora ka mundësinë që të përfshihet në procesin legjislativ përmes të ashuquajturës zonë e 11-të zgjedhore si zonë e veçantë krahas asaj të minoriteteve (Qeveria e Republikës Kroate, n.d.). Të gjithë qytetarët që kanë nënshtetësi kroate mund të votojnë në misione diplomatike apo konsullata të Republikës Kroate dhe përveç zgjedhjeve parlamentare, kroatët që jetojnë jashtë vendit mund të votojnë edhe në zgjedhjet presidenciale, zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe referendimet kombëtare.

### 5.3 Izraeli

Diaspora izraelite pa dyshim përbën një nga diasporat më të veçanta në botë për faktin që shteti i Izraelit u krijua si përgjigje e përpjekjeve shekullore të diasporës izraelite për të themeluar shtetin e tyre. Por edhe pas më shumë se 70 viteve që nga krijimi i shtetit të Izraelit sipas një studimi nga [Pew Research Center](#), shumica e qytetarëve izraelit mendojnë se roli i diasporës izraelite është vital për mbijetesën afatgjatë të hebrenjeve të cilët ofrojnë mbështetje politike/ideologjike, kulturore dhe religjioze për shtetin e Izraelit (2016). Izraeli është një nga shembujt më të mirë të diplomacisë së diasporës që nënkupton angazhimin e komunitetit të diasporës izraelit kudo në botë për të mbajtur lidhjet emocionale me shtetin amë (ruajtjen dhe promovimin e identitetit izraelit dhe përfundimin e lidhjes së Izraelit me shtetet në të cilat jeton komuniteti izraelit).

Për qëllimet e kësaj analize do të elaborojmë: a) themelimin e programit të mirënjohur “[Birthright Israel](#)” si një përpjekje e filantropëve izraelitë në bashkëpunim me qeverinë izraelite për të fuqizuar lidhjen dhe identitetin hebre të të rriturve në diasporë me origjinë izraelite dhe b) Rolin e diasporës izraelite në zhvillimin ekonomik, më saktësisht në fushën e inovacionit dhe teknologjisë.

Birthright Israel programi formalisht u themelua më 1994 dhe nga viti 1999 deri më tani kanë përfituar mbi 800.000 të rinjë me origjinë izraelite nga 68 shtete në botë (Birthright Israel Foundation, 2024). Programi synon që këtë lidhje emocionale ta kultivojë dhe promovojë përmes ofrimit të një udhëtimi 10 ditësh të të rinjëve me origjinë izraelite në Izrael ku secili ekskurzion pa marrë parasysh nga operatori që ofron atë, fokusohet në çështjet e identitetit, gjeopolitikës dhe stilit të jetesës së hebrenjeve përmes vizitave dhe ligjëratave të ndryshme. Ndonëse të gjitha shpenzimet mbulohen nga programi dhe në parim nuk pritet asgjë nga pjesëmarrësit, pas përfundimit të këtij rrugëtimi impakti i tij është dëshmuar nga gatishmëria e pjesëmarrësve për tu angazhuar nëpër organizata, shoqata, dhe aktivitete të tjera përcjellëse me synim të promovimit të identitetit të tyre. Përveç Birthright Israeli, programi ka themeluar [Fondacionin Birthright Israeli](#) përmes të cili mbulohen mbi 65% të shpenzimeve. Shumica e donatorëve të Fondacionit janë donacione nga Amerika Veriore (pothuajse 100 milionë dollar çdo vit). Pjesa tjetër e shpenzimeve të programit mbulohen nga vet shteti i Izraelit (27%) dhe një pjesë e vogël nga donacione dhe agjenci të tjera në Izrael. Padyshim që ky rast duhet të shërbejë si motivim për qeverinë e Kosovës që të rrisë mbështetjen për programin OriginAL që është bazuar kryekput në konceptin e Birthright Israel.

Një fushë tjetër i cila meriton vëmendje të veçantë në këtë analizë meqë mund të inspirojë politika dhe strategji të ngjashme, është tërheqja e ndërmarrësve të rinjë nga diaspora për të investuar ose shtrirë veprimtarinë e tyre në vendin e origjinës. Izraeli ka kohë që e ka marrë epitetin si “kombi start-ups” (start-up nation) dhe aktualisht kryeqyteti izraelit – Tel Avivi listohet i 6-ti në botë si lokacion i teknologjisë pas Silicon Valley, New York City, Beijing dhe Boston (Schäfer & Henn, 2023). Një rol kyç në suksesin global të izraelit në fushën e teknologjisë dhe start-ups e ka kryekëput diaspora izraelite. Në artikullin e tyre që analizon suksesin e Izraelit si komb i ndërmarrësisë, Schäfer dhe Henn (2023) sqarojnë fazat dhe arsyet si ka ndodhur kjo. Sipas tyre, secila nga fazat e zhvillimit të skenës së teknologjisë së lartë në Izrael është e lidhur direkt me dinamikat e migrimit duke dalluar tri faza të këtij zhvillimi. Faza e parë - ajo e “pre-emergence” karakterizohet me rimigrimin e “Argonautëve të rinjë” që përbëhej nga izraelitë më aftësi të larta (highly skilled) të cilët shkuan për studime në Amerikë dhe punuan në Silicon Valley për tu kthyer më vonë në Izrael kryesisht për arsye atëdhedashëse dhe familjare. Për shkak të përvojës dhe rrjetëzimit të tyre ishin pikërisht këta individë të cilët e filluan suksesshëm ekosistemin e start-ups përmes sigurimit të fondeve për investime dhe më vonë shitjes së produkteve direkt në tregun amerikan dhe evropian, apo në disa raste edhe për të udhëhequr degë të kompanive amerikane me seli në Izrael. Faza e dytë - ajo e “emergence” - karakterizohet nga migrimi i përhershëm i hebrenjve nga diaspora për arsye ekonomike pikërisht për shkak të kontekstit të rritjes së industrisë së teknologjisë. Për shembull, sipas të dhënave nga censusi i US, qytetarët izraelit të cilët migruan në SHBA dhe u kthyen në Izrael pas 10-15 viteve ishin më të arsimuar për dallim nga qytetarët izraelit të cilët qëndruan në SHBA. Që nga viti 2008, konsiderohet që industria e teknologjisë së lartë të Izraelit ka hyrë në fazën e tretë, atë të rritjes çka e demonstroi edhe numri i start-ups, niveli i investimeve të huaja dhe numri i marrëveshjeve me korporata të mëdha dhe jo vetëm. Pra, përderisa dy fazat e para të zhvillimit karakterizohen nga procese të migrimit drejt Izraelit, faza e tretë e rritjes karakterizohet kryesisht me migrantët izraelitë të cilët jashtë vendit kanë ndërtuar lidhje transnacionale ndërmjet Izraelit dhe vendeve të huaja kryesisht në SHBA dhe vendet e Bashkimit Evropian. Poashtu, një meritë e madh kanë Rrjetet e Izraelitëve jashtë, që përbëhet kryesisht nga ndërmarrës dhe investitorë të tjerë të cilët ndihmojnë posaçërisht ndërmarrësit e rinjë pa përvojë duke i lidhur ata me investitorë potencialë. (Schäfer & Henn, 2023)

Izraeli është një nga shembujt më unik të kalimit nga një ekonomi agrare të një nga ekosistemet më dinamike të teknologjisë së lartë në botë duke marrë epitetin e parajsës për ndërmarrës, investitorë dhe inovatorë. Siç u elaborua, përveç migrimit dhe diasporës një rol shumë të madh luan edhe qeveria izraelite. Qeveria izraelite ka themeluar [Autoritetin Izraelit për Inovacion](#) duke listuar inovacion si një nga burimet kryesore natyrore të Izraelit falë fuqisë punëtore ndër të tjera. Ky autoritet i cili është i pavarur dhe i financuar nga shteti është krijuar për të siguruar një sërë mjetesh praktike dhe platformave për sponsorizim të inovacionit. Agjencioni përkrah ndërmarrës në fazat e para, kompanitë e maturuara të cilat zhvillojnë produkte të reja, grupe akademike të cilat kërkojnë të transferojnë idetë e tyre në treg, korporatat globale të interesuara për bashkëpunim me sektorin e teknologjisë në Izrael, kompanitë izraelite të cilat kërkojnë tregje të reja jashtë etj. Në kuadër të kësaj agjencie poashtu është themeluar edhe Fondi për Start-up për të mbështetur sidomos kompanitë në fazat e tyre fillestare varësisht nga situata me 60%, 50% apo 30% rë shumës totale të investimit (Israel Innovation Authority, 2024).

<sup>4</sup>Term gjithëpërfshirës për ndërmarrësit e aftë teknikisht të cilët udhëtojnë midis Silicon Valley dhe vendeve të tyre të origjinës

## 6. Përfundime dhe Rekomandime

Diaspora e Kosovës dhe ajo shqiptare në përgjithësi ka luajtur dhe vazhdon të luaj rol të shumëanshëm për kombin dhe shtetin. Përderisa entuziazmi dhe potenciali i diasporës është i padiskutueshëm, mungesa e një strategjie shtetërore dhe kombëtare për të shfrytëzuar këtë potencial mbetet sfida kryesore. Pra, përveç asaj se çka dhe si ofron diaspora, qeveria e Kosovës duhet ta ketë të qartë se çfarë ajo ofron për diasporën. Qartazi, iniciativat e fundit të institucioneve të Kosovës për të angazhuar diasporën në mënyrë aktive dhe konstruktive janë hapa të mirë në këtë drejtim, të cilat sidoqoftë kërkojnë më tutje përkushtim dhe koordinim të kësaj qasje.

Diaspora e Kosovës dhe ajo shqiptare në përgjithësi ka luajtur dhe vazhdon të luaj rol të shumanshëm për kombin dhe shtetin. Përderisa entuziazmi dhe potenciali i diasporës është i padiskutueshëm, mungesa e një strategjie shtetërore dhe kombëtare për të shfrytëzuar këtë potencial mbetet sfida kryesore. Pra, përveç asaj se çka dhe si ofron diaspora, qeveria e Kosovës duhet ta ketë të qartë se çfarë ajo ofron për diasporën. Qartazi, iniciativat e fundit të institucioneve të Kosovës për të angazhuar diasporën në mënyrë aktive dhe konstruktive janë hapa të mirë në këtë drejtim, të cilat sidoqoftë kërkojnë më tutje përkushtim dhe koordinim të kësaj qasje.

Potenciali i shumë diskutuar i diasporës rrezikon të mos materializohet nëse qeveria dhe shoqëria kosovare nuk ecën me hapa të përshpejtuar për të përmirësuar gjendjen aktuale. Analiza e nevojave nënvizon nevojën për bashkërendim të prioritetëve dhe punës ndërmjet Qeverisë, MPJD-së, KPPJD, komunave, misionëve diplomatike dhe diasporës me qëllim të krijimit dhe realizimit të vizionit të përbashkët për një Kosovë ku diaspora flet dhe dëgjohet. Përkundër potencialit ekonomik, social e kulturor diaspora ballafaqohet me sfidat të të gjitha formave, shpesh edhe më banale të cilat mund të gërryejnë besimin, vullnetin dhe dëshirën e diasporës për të kontribuar në një Kosovë të qëndrueshme politikisht dhe ekonomikisht. Padyshim që problemet e identifikuar në këtë analizë nuk mund të pretendojmë që janë shteruese mirëpo japin nja pasqyrë të përgjithshme të sfidave më të spikatura të cilat kërkojnë angazhim maksimal institucional.

Diaspora shqiptare ka ndryshuar trajektoren historike të Kosovës në periudhën më të errët të saj dhe sot ka kapacitetin për ta transformuar të tashmen dhe ardhmen. Përveç rekomandimeve për përmirësimin e çështjeve të përgjithshme të qeverisjes (përmirësimin e klimës për investime, luftimit të korrupsionit, sundimit të ligjit etj.) disa nga rekomandimet konkrete për institucionet shtetërore janë si vijon:

## **Për Qeverinë e Kosovës / Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës:**

1. Përderisa qeveria e Kosovës është duke finalizuar strategjinë për diasporën, MPJD duhet të sigurohet që ky plan përcillet me objektiva të matshme, ndarje të përgjegjësive, koordinim ndër-institucional, monitorim dhe vlerësim të implementimit të strategjisë dhe përfshirje maksimale të diasporës në çdo hallkë të procesit.
2. Ngjashëm me shembullin e Kroacisë, qeveria e Kosovës duhet të shqyrtojë mundësinë e krijimit të një platforme qendrore dixhitale veçmas për diasporën ku ofrohen të gjitha informatat në lidhje me ndryshimet ligjore që afektojnë diasporën, përditësimet e politikave, mundësitë për investime, ngjarjet kulturore, programet dhe bursat që targetojnë diasporën, materiale edukative në gjuhën shqipe etj. Të pasurit e një adrese të vetme për diasporën do të përmirësonte komunikimin dhe ndarjen e informatave duke shmangur konfuzionin.
3. Organizimi i ngjarjeve në formë të forumeve për investime ku krijohen kushte për rrjetëzim ndërmjet investitorëve nga diaspora dhe biznesve vendore. Lidhur me këtë qeveria mund të konsiderojë krijimin e një databaze të veçantë të investitorëve dhe bizneseve nga diaspora.
4. Bashkëpunimi i ngushtë me misionet diplomatike për promovimin e potencial të investimeve në Kosovë. Aty ku është e mundur të caktohen atashë ekonomikë nëpër misionet diplomatike të Republikës së Kosovës për të promovuar dhe lehtësuar ndër të tjera komunikimin ndërmjet investitorëve në vendit pritës me vendin amë.
5. Krijimi i kushteve për mundësinë e bartjes së eksperiencave të profesionistëve shqiptarë në diasporë përmes shfrytëzimit të kanaleve dixhitale aty ku fizikisht nuk është e mundur.
6. Të intensifikohet bashkëpunimi me misionet diplomatike me diasporën nëpërmjet kampanjave sensibilizuese rreth mundësisë së mësimi plotësues në gjuhën shqipe në diasporë dhe rëndësisë së ruajtjes së identitetit shqiptar në diasporë. Kjo mund të bëhet nëpërmjet a) promovimit dhe shpërndarjes së materialeve edukative dhe arsimore online; dhe b) përkrahjes së projekteve kulturore dhe ofrimit të bursave për të rinjtë nga diaspora. Nëse rrethanat lejojnë, qeveria mund të konsiderojë themelimin e qendrave të reja kulturore apo instituteve në qytetet me koncentrim më të lartë të diasporës.
7. Inkurajimi i qytetarëve të Kosovës nga diaspora që gjatë kohës së qëndrimit të tyre të pajisen me dokumente valide të identifikimit përmes kampanjave vetëdijësuese. Në koordinim me komunitatet të shqyrtohet mundësia e lehtësimit dhe përsheptimit të procedurave burokratike me theks të veçantë gjatë muajve të verës kur fluksi i diasporës është dukshëm më i madh. Pajisja me dokumente valide të identifikimit do të shmangte problematikat administrative gjatë kohës së zgjedhjeve sidomos atyre të parakohshme.
8. Informimi më kohë i diasporës në lidhje me ndryshimet ligjore që i prekin direkt interesat e tyre, p.sh ndryshimi i Ligjit për Zgjedhje dhe se si ndikon kjo mënyrën e votimit.
9. Mbështetja afatgjate institucionale për programet dhe organizatat që punojnë kundër asimilimit dhe angazhohen drejt lidhjes së të rinjëve të diasporës me vendin amë.
10. Konsultimi dhe informimi i rregullt i diasporës para finalizimit të marrëveshjeve ndërshtetërore të cilat prekin interesin e tyre.

## **Për Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme dhe Diasporë**

1. Të bëjë thirrje për përfshirjen e diasporës në proceset vendim-marrëse p.sh përmes ftesës për takime të përfaqësuesve nga diaspora kur diskutohen çështje me interes për diasporën.
2. Të luajë rol proaktiv në monitorimin e punës së MPJD-së kundrejt diasporës duke e përfshirë temën e diasporës në takimet e rregullta të komisionit përtej rasteve të raportimit të punës së ministrës në komision.
3. Të marrë pjesë aktive në takimet ndërmjet MPJD-së dhe komunitetit të diasporës për të siguruar transparence dhe gjithëpërfshirje.
4. Të llojë për çështjet me interes të diasporës shqiptare gjatë takimeve me komisionet homologe të vendeve të tjera.
5. Të organizojë takime të veçanta me komunitetin e diasporës për të kuptuar më mirë nevojat, sfidat dhe pritshmëritë e diasporës ndaj institucioneve shtetërore dhe në bazë të tyre të kërkojë llogaridhënie nga MPJD në rast të mos përmbushjes. Këto takime do të përqonin mesazhin e unitetit politik ndaj çështjeve të diasporës pa dallime partiake.

## 7. Referencat

1. Adamson, F. B. (2016). The Growing Importance of Diaspora Politics. *Current History*, 115(784), 291–297. <https://www.jstor.org/stable/48614196>
2. Aikins, K. (2014). Diaspora matters: Kingsley Aikins at TEDxVilnius. YouTube. [https://www.youtube.com/watch?v=yQ\\_y5LgM7D0](https://www.youtube.com/watch?v=yQ_y5LgM7D0)
3. European Parliament. (2022). The role of remittances in promoting sustainable development. Qasur nga [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2022/702563/EXPO\\_IDA\(2022\)702563\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/IDAN/2022/702563/EXPO_IDA(2022)702563_EN.pdf)
4. Germin. (2021). Out of Country Voting 2021 [PDF]. Qasur nga <https://germin.org/wp-content/uploads/2021/07/English-copy.pdf>
5. Germin. (2024). Harnessing the potential of the Kosovar diaspora's economic contributions. Qasur nga <https://germin.org/harnessing-the-potential-of-the-kosovar-diasporas-economic-contributions/>
6. Government of the Republic of Croatia. (2024). Voting of members of the Croatian diaspora. Qasur nga <https://gov.hr/en/voting-of-members-of-the-croatian-diaspora/1660>
7. International Fund for Agricultural Development. (2021). Helping remittances reach rural areas in Moldova. Qasur April 19, 2024, nga [https://www.ifad.org/en/web/latest/-/helping-remittances-reach-rural-areas-in-moldova?p\\_1\\_back\\_url=%2Fen%2Fsearch%3Fq%3Dremittances%2Bmoldova](https://www.ifad.org/en/web/latest/-/helping-remittances-reach-rural-areas-in-moldova?p_1_back_url=%2Fen%2Fsearch%3Fq%3Dremittances%2Bmoldova)
8. Israel in novation Authority. (2024). Start-Up Fund. Qasur May 4, 2024, nga <https://innovationisrael.org.il/en/programs/startup-fund/>
9. IOM. (2022). World Migration Report 2022. Qasur nga <https://worldmigrationreport.iom.int/wmr-2022-interactive/>
10. Klan Kosova. (2023, May 16). Për 15 vjet kosovarëve iu shtua nënshpëtimet serbe, MPJ heshti [Video]. YouTube. <https://www.youtube.com/watch?v=Yc7Iwr4eLCM>
11. Kusari, K. (2017). Sigurimi kufitar: Manifestim i neglizhencës së institucioneve kosovare. Organizata Shqiptare. Qasur nga <https://organizatatshqiptare.germin.org/sigurimi-kufitar-manifestim-i-neglizhencës-se-institucioneve-kosovare/>
12. Murphy, C. B. (2024, March 5). Remittance: What it is and how to send one. Investopedia. Qasur nga <https://www.investopedia.com/terms/r/remittance.asp>
13. Nacionale.com. (2022). Diaspora dërgoi mbi 1 miliard euro remitanca deri në shtator 2022. Qasur nga <https://nacionale.com/politike/diaspora-dergoi-mbi-1-miliard-euro-remitanca-deri-ne-shtator-2022>
14. Perteshi, S. (2020, December 18). Si ta mbajmë afër diasporën? Kosovo 2.0. <https://kosovotwopointzero.com/si-ta-mbajme-afër-diasporën/>
15. Pew Research Center. (2016). Views of the Jewish state and the diaspora. Qasur nga <https://www.pewresearch.org/religious-landscape-study/2016/03/08/views-of-the-jewish-state-and-the-diaspora/>

16. Radio Evropa e Lirë. (2023). Kosova përfitoi miliarda euro nga remitencat. Qasur nga <https://www.evropaelire.org/a/31311096.html>
17. RajoniPress.com. (2022). Remitencat në rritje, ekspertët bëjnë thirrje të orientohen në prodhim, jo veç në konsum e patundshmëri. Qasur nga <https://rajonipress.com/remitencat-ne-rritje-ekspertet-bejne-thirrje-te-orientohen-ne-prodhim-jo-vec-ne-konsum-e-patundshmëri/>
18. Schäfer, S., & Henn, S. (2023). Start-up nation Israel: Transnational entrepreneurs, born globals, and cross-border connections of the Israeli high-tech industry. ResearchGate. [https://www.researchgate.net/publication/370864115\\_Start-up\\_nation\\_Israel\\_transnational\\_entrepreneurs\\_born\\_globals\\_and\\_cross-border\\_connections\\_of\\_the\\_Israeli\\_high-tech\\_industry](https://www.researchgate.net/publication/370864115_Start-up_nation_Israel_transnational_entrepreneurs_born_globals_and_cross-border_connections_of_the_Israeli_high-tech_industry)
19. Sisko, C. (2015, October 13). What Have We Learned About Engaging Diasporas? Chemonics. Qasur nga <https://chemonics.com/blog/what-have-we-learned-about-engaging-diasporas/>
20. United Nations Network on Migration. (2019). Moldova: First-ever international remittance transfer through Saving and Credit Association. Qasur April 19, 2024, nga <https://migrationnetwork.un.org/practice/moldova-first-ever-international-remittance-transfer-through-saving-and-credit-association>
21. Venice Commission. (2011). Report on out-of-country voting. [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2011\)022-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2011)022-e)
22. World Bank. (2022). Personal remittances, received (% of GDP) – Kosovo. Qasur nga <https://data.worldbank.org/indicator/BX.TRF.PWKR.DT.GD.ZS?locations=XX>
23. World Bank. (2022). Personal remittances, received (% of GDP) – Moldova. Qasur nga <https://data.worldbank.org/indicator/BX.TRF.PWKR.DT.GD.Z>
24. World Bank (Ed.). (2023, July). World development report 2023: Migrants, refugees, and Societies. World Bank. Qasur nga <https://www.worldbank.org/en/publication/wdr2023>
25. LIGJI NR. 04/L – 095 . (2012, July 3). LIGJI NR. 04/L – 095 PËR DIASPORËN DHE MËRGATËN. Qasur nga <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=283>



## Lajmet nga MPJD:

- <https://mfa-ks.net/lajmet/mpjd-dhe-usaid-kosovo-compete-activity-nenshkruajne-marreveshje-bashkepunimi/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/prezantohen-10-kandidatet-e-pare-te-programit-per-diplomaci-qytetare>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/zevendesministrja-gashi-te-fokusuar-ne-thellim-te-bashkepunimit-dhe-marredhenieve-kosove-bavari/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/simpoziumi-per-rolin-e-diaspores-shkencore-ne-mynih/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/ministria-e-puneve-te-jashtme-dhe-diaspores-e-perkushtuar-per-angazhimin-e-te-rinjve-nga-diaspora/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/zevendesministrja-gashi-angazhimi-i-diaspores-shume-i-rendesishem-per-zhvillimin-e-kosoves/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/diaspora-fokus-i-diskutimeve-te-zevendesministres-gashi-ne-tirane/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/lancohet-java-e-kultures-se-kosoves-jashte-vendit/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/thirrje-per-projektpropozime-per-perfshirjen-e-te-rinjve-nga-diaspora-2023/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/zevendesministrja-gashi-se-bashku-me-zv-dobruna-kane-organizuar-nje-takim-koordinues-me-pjesemarresit-e-komunave-te-kosoves-qe-jane-pjese-e-kolegjiumit-per-diaspore/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/zevendesministrja-gashi-mori-pjese-ne-konferencen-migrimi-dhe-zhvillimi/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/mpjd-lanson-platfermen-online-dedikuar-mergates-shijokosoven/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/dites-se-diaspores-ministria-e-puneve-te-jashtme-dhe-diaspores-dhe-zyra-e-kryeministrit-te-republikes-se-kosoves-organizuan-nje-pritje-te-vecante-per-bashkatdhetaret/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/mpjd-permes-programit-per-diplomaci-qytetare-angazhon-profesionistet-e-rinj-nga-mergata/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/ministrja-gervalla-merr-pjese-ne-hapjen-e-zyres-se-unionit-te-bizneseve-shqiptaro-gjermane-ne-kosove/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/zevendesministrja-gashi-avancimi-i-rolit-te-mesuesit-dhe-institucionalizimi-i-gjuhes-shqipe-ne-diaspore-eshte-i-domosdoshem/>
- <https://mfa-ks.net/lajmet/hapet-forumi-nderkombetar-ulpiana/>

- 
- <https://mfa-ks.net/lajmet/ministrja-gervalla-do-te-bashkebisedoje-me-mergaten-ne-gjermani/>
  - <https://mfa-ks.net/lajmet/zevendesministrja-gashi-180-mije-pjesetare-te-diaspores-u-regjistruan-deri-tani-inkurajojme-bashkeatdhetaret-te-regjistrohen/>

## ANEKS:

1. Takime me nivelin lokal dhe qendror - korrik 2021  
Aktivitetet që lidhen direkt me diasporën, Ministrka Gërvalla-Schwarz i filloi në korrik të vitit 2021, kur dhe numri më i madh i mërgimtarëve udhëtojnë drejt Kosovës për të kaluar pushimet verore. Këto aktivitete ajo i nisi me vizitat nëpër komuna me qëllimin e informimit me shërbimet e ofruara ndaj diasporës në nivelin lokal, sfidat, aktivitetet kulturore si dhe mundësinë e ngritjes së bashkëpunimit ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror. Pas vizitave nëpër komuna, Ministria në po të njejtin muaj u takua me drejtuesit e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve lidhur me mungesën e informimit të diasporës rreth procedurave të votimit jashtë vendit dhe gatishmërinë e Ministrisë për të facilituar KQZ-në shperndarjen e informatave me kohë. Takimet e rradhës u organizuan me Agjencinë e Regjistrimit Civil e cila ballafaqohet me fluksin më të madh të kërkesave gjatë muajve të verës dhe menaxhmentin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHT), MPJD në korrik poashtu mirëpriti në takim një grup të mësuesve nga diaspora për të diskutuar mbi procesin e mësimit plotësues të gjuhës shqipe. Qëllimi i diskutimit sipas Ministrës ishte që të identifikohen nevojat dhe kërkesat e mësimeve dhe në bazë të tyre të bëhen hapa konkretë për ti adresuar ato.
2. Takim me diasporën në kuadër të “Dialogut me Diasporën” - gusht 2021.  
Në gusht të vitit 2021 ministria filloi të ashtuquajturin “Dialogu me Diasporën” duke realizuar një sërë takimesh fizike dhe virtuale me përfaqësues të shoqatave të ndryshme të diasporës përfshirë edhe Këshillin Kombëtar të Diasporës (KKD). Sipas Ministrisë, ky dialog i paraprinë strategjisë së re për diasporën dhe qasjen e re të Qeverisë dhe Ministrisë ndaj diasporës. Gjatë takimit u diskutuan sfidat dhe prioritetet e Ministrisë ndaj diasporës ku u përmend ndër të tjera lidhja e mërgatës me Kosovën, përmiresimi i shërbimeve nëpër konsullata dhe ambasada dhe transferi i dijës nga mërgata në Kosovë.
3. Takim me shoqatat shqiptare në Vjenë - tetor 2021  
Zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, znj.Liza Gashi, takohet me përfaqësues të shoqatave të profesionistëve të diasporës shqiptare në Vjenë duke theksuar interesin e Qeverisë së Kosovës për kthimin e potencialit në të mirë të Kosovës dhe krijimin e mekanizmave që do të mundësojnë këtë bashkëpunim sidomos në fushat e inovacionit, arsimit dhe investimeve.
4. Themelohet Kolegjiumi për Diasporë brenda Asociacionit të Komunave të Kosovës - korrik 2022.  
Ministrja Gërvalla-Schwarz nënshkruan memorandumun e bashkëpunimit me kryetarin e Asociacionit të Komunave të Kosovës z.Agim Aliu, me qëllim të krijimit të Kolegjiumit për Diasporë që për herë të parë të institucionalizohet përfshirja e komunave në kuadër të programeve dhe aktiviteteve të Ministrisë për dhe me diasporën. Sipas marrëveshjes, palët nënshkruese dhe të krijojnë kushtet për angazhimin e diasporës në politika zhvillimore dhe nxitjen e investimeve përpos bashkrendimit të aktiviteteve të diasporës në nivel lokal.
5. MPJD shpalos dy programe për mërgatën, Karvani i Diasporës dhe Programi për Diplomaci Qytetare - korrik 2022.  
Dy programet u shpalosën gjatë një konferece për media të MPJD-së. Karvani i Diasporës si program rrugëtoji nëpër qytetet e Kosovës me qëllim të takimeve, bashkëbisedimeve

dhe shkëmbimeve të ideve dhe projekteve kulturore me diasporën. Ndërsa, Programi për Diplomaci Qytetare u prezantua si pilot-projekt dhe materializimi i tij ndodhi pak muaj më vonë siç do ta shohim në kronologjinë e ofruar. Programi synon përfshirjen e të rinjëve të diasporës në institucionet e Republikës së Kosovës.

6. MPJD diskuton me OJQ-të rreth edukimit jo-formal të të rinjëve nga diaspora - shtator 2022  
Për herë të parë MPJD ftoi organizatat kryesore joqeveritare për të diskutuar rreth edukimit joformal të të rinjëve nga diaspora, rolit që secila nga organizatat e ftuara mund ta marrë për këtë çështje dhe mundësisë së krijimit të një programi kombëtar vjetor për fëmijët dhe të rinjtë nga diaspora. Qëllimi sipas MPJD-së është që të krijohet një lidhje e fëmijëve dhe të rinjëve nga diaspora e cila shkon përtej lidhjes familjare.
7. Qeveria merr dy vendime mbi angazhimin e diasporës në sektorin e shëndetësisë - 30 shtator 2022.  
Në mbledhjen e rregullt të Qeverisë në shtator të vitit 2022, MPJD në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) njoftojnë para medieve për marrjen e dy vendimeve për mundësinë e angazhimit të diasporës në sektorin e shëndetësisë. Këto vendime janë:  
a) heqja e lejeve të përkohshme të punës për profesionistët shëndetësorë nga mërgata që janë të interesuar të angazhohen në sistemit shëndetësor në Kosovë; dhe b) aprovimi i udhëzuesit për angazhimin e profesionistëve të huaja shëndetësorë në MSH. Vendimet synojnë të lehtësojnë barrierat administrative ekzistuese për diasporën dhe përfshirjen e tyre në sektorin e shëndetësisë në këtë rast.
8. Lansimi i Programit “Diplomacia Qytetare” - 7 nëntor 2022.  
Qeveria e Kosovës, përkatësisht MPJD për herë të parë lanson programin “Diplomacia Qytetare” si përpjekje e parë për të institucionalizuar diplomacinë qytetare që filloi me gjeneratën e parë të të rinjëve nga diaspora. Përfitues të programit ishin 10 të rinjë nga diaspora të cilët u angazhuar për rreth 6 muaj në institucionet kosovare. Qëllimi i programit është që të rinjtë nga diaspora të kontribuojnë direkt në institucionet e Kosovës duke ndarë përvojat e tyre dhe në këtë mënyrë të krijojnë një lidhje të qëndrueshme me shtetin e Kosovës.
9. Takime zyrtare ndërmjet MPJD-së dhe komunitetit shqiptar në Bavari - 24 nëntor 2022  
Zv.Ministrja për Punë të Jashtme dhe Diasporë pati një sërë takimesh në landin e Bavarisë me ndërmarrës, biznesmenë dhe profesionistë të tjerë me qëllim që të thellohet bashëpunimi midis bizneseve në Kosovë dhe atyre në Bavari. Sidoqoftë, nuk dihet nëse këto takime kanë prodhuar ndonjë rezultat konkret. Përvëç kësaj, takime janë zhvilluar edhe me Institutin Albanologjik ku është diskutuar për çertifikimin e gjuhës shqipe si një nga sfidat kryesore të institucionalizimit të gjuhës shqipe në diasporë.
10. MPJD merr pjesë në simpoziumin mbi rolin e Diasporës shkencore në Mynih - 25 nëntor 2022.  
MPJD zotohet për mbështetjen e programeve, projekteve dhe nismave që mundësojnë angazhimin dhe komunikimin e komunitetit shkencor në Kosovë me atë në diasporë.
11. MPJD nënshkruan Memorandum të Mirëkuptimit me “Teach for Kosova” – 26 nëntor 2022.

MPJD nënshkruan Memorandum të Mirëkuptimit me organizatën Teach for Kosova me qëllim të angazhimit të liderve të rinjë nga Kosova dhe Diaspora për të kontribuar në arsimin parauniversitar të Kosovës.

12. Takime zyrtare ndërmjet MPJD dhe Republikës së Shqipërisë - 3 mars 2023.  
Zv.Ministrja e MPJD-së, Znj.Liza Gashi merr pjesë në vizitë zyrtare në Republikën e Shqipërisë ku të dyja palët diskutuan kryekput për diasporën, shkëmbimin e praktikave, tekstet shkollore në shkollat shqipe në diasporë, unifikimin e tyre dhe mundësia e krijimit të një platforme dixhitale e cila përmendet edhe në ligjin aktual për diasporë. Një temë tjetër që u përmend ishte hapja e qendrave të përbashkëta kulturore.
13. Lansohet Java e Kulturës së Kosovës - 15 mars 2023  
Lancohet Java e Kulturës së Kosovës nga MPJD në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS). Ky program ka për qëllim promovimin e kulturës kosovare në skenën ndërkombëtare me qëllim të rritjes së komunikimit dhe ndërveprimit midis artistëve vendor, diasporës dhe artistëve të vendeve pritëse. Vendi i parë pritës ishte Portugalia.
14. MPJD lanson thirrje publike për mbështetje financiare të projekteve për përfshirjen e të rinjëve nga diaspora - 15 mars 2023
15. Takim koordinues me Kolegjiumin për Diasporë - 27 mars 2023  
MPJD dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal organizojnë takim koordinues me pjesëmarrësit e komunave të Kosovës që janë pjesë e Kolegjiumit për Diasporë.
16. Lansohet platforma “Shijo Kosovën” - 25 korrik 2023  
MPJD lancon për herë të parë platformën online dedikuar kryekput diasporës me emrin “Shijo Kosovën”. Sipas Ministrisë platforma është lancuar si rezultat i punës së përbashkët midis institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe diasporës.
17. Aprovohet Programi për Diplomaci Qytetare për vitin 2023-2025 - 9 gusht 2023  
Qeveria e Republikës së Kosovës aprovon Programin për Diplomaci Qytetare për vitin 2023-2025 me qëllim të forcimit të lidhjes së të rinjëve nga diaspora me institucionet e Republikës së Kosovës përmes angazhimit të tyre nëpër institucione publike deri në 10 muaj me financim nga institucionet e Kosovës. Programi për herë të parë u lansua në nëntor të vitit 2022.
18. Organizohet Forumi Ndërkombëtar “Ulpiana” - 16 nëntor 2023  
Organizohet për herë të parë Forumi Ndërkombëtar “Ulpiana” në Prishtinë nën patronatin e MPJD-së me pjesëmarrës nga fusha të ndryshme duke përfshirë akademinë, shoqërinë civile, biznesin etj. Temat u përqëndruan rreth angazhimit të diasporës dhe zhvillimeve ndërkombëtare. Përfaqësuesit shtetërore rikonfirmuan mbështetjen e qeverisë aktuale për diasporën dhe adresimin e sfidave të saj. Në një pjesë të fjalimit, kryeministri Albin Kurti, ndër të tjera ritheksoi përkushtimin e qeverisë së tij në përafrimin e diasporës dhe fuqizimin e ndjenjës së përkatësisë si mënyra më e mirë për të bërë lidhjen e aftësive dhe talenteve të diasporës me vendin amë.
19. Hapet zyra e Unionit të Bizneseve Shqiptaro-Gjermane në Kosovë - 25 nëntor 2023  
Gjatë ceremonisë së hapjes së kësaj zyre MPJD rithekson mbështetjen e saj ndaj iniciativave të tilla dhe promovimit të prosperitetit ekonomik dhe bashkëpunimit të biznesve shqiptare me ato në diasporë. Sidoqoftë, MPJD nuk pati rol në themelimin e saj.

20. Mbahet samiti i tretë i Diasporës në Tiranë - 23 nëntor 2023  
Në Tiranë organizohet samiti i tretë i Diasporës ku ndër të tjera diskutohet rreth mbështetjes së mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë dhe më konkretisht rreth mësimin plotësues, rolin e mësuesve, teksteve shkollore, mundësinë për zhvillimin e një platforme online të përbashkët, dhe kualifikimin e mësuesve në diasporë. Por, është e nevojshme të përmendët që MPJD pati vetëm rol pjesëmarrës në këtë samit dhe jo atë organizues meqë samiti u organizua nga qeveria shqiptare.
21. Takime të MPJD-së me diasporën në Belgjikë - 10 dhjetor 2023  
Ministra Gërvalla-Schwarz së bashku me Ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural takohen me shoqatat dhe komunitetin shqiptarë në Belgjikë. Gjatë takimit Ministria Gërvalla-Schwarz rithekson vizionin e institucioneve të Kosovës për përfshirje të gjeneratave të ndryshme të mërgatës në jetën sociale, politike dhe ekonomike në Kosovë në njërin anë dhe mbështetjen e perpjekjeve të diasporës për ruajtjen e gjuhës dhe identitetit shqiptar në diasporë.
22. Mbahet ceremonia e prezantimit të gjeneratës së dytë të bursistëve të Programit për Diplomaci Qytetare - 19 dhjetor 2023  
MPJD organizon ceremoninë zyrtare të prezantimit të 23 bursistëve nga diaspora në kuadër të programit Për Diplomaci Qytetare. Bursistët e përzgjedhur vijnë nga 14 shtete të botës dhe kanë mundësinë që të japin kontributin e tyre për 10 muaj nëpër Ministri të ndryshme të Republikës së Kosovës.
23. Takime me komunitetin shqiptar në Kanadë – shkurt 2024  
Zëvendësministrja Liza Gashi gjatë vizitës zyrtare në Kanadë, takohet me përfaqësuesit e diasporës shqiptare në tre qytetet kryesore në Kanadë (Otava, Toronto dhe Hamilton). Gjatë takimit u diskutua për Strategjinë dhe Ligjin e ri të Diasporës i cili pritet ende të dalë në diskutim.
24. Bashkëbisedim me mërgatën shqiptare në Gjermani - 17 mars 2024  
MPJD ftoi publikisht mërgatën shqiptare në Gjermani për bashkëbisedim rreth situatës aktuale në Kosovë, votimin në diaspora, mësimin plotësues dhe regjistrimin e mërgatës.
25. Lancohet platforma për regjistrimin e diasporës E-diaspora - 13 prill 2024  
Republika e Kosovës fillon për herë të parë regjistrimin online të diasporës për të gjithë qytetarët që kanë lindur në Kosovë ose që kanë prejardhje nga Kosova që jetojnë në diasporë. Platforma e quajtur E-diaspora është bashkëpunim i MPJD-së dhe Agjencionit të Statistikave të Kosovës (ASK) në kuadër të Regjistrimit të Popullësisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave. Qëllimi i regjistrimit sipas MPJD-së është të kuptohet gjendja dhe nevojat e qytetarëve në diasporë me qëllim të planifikimit adekuat të politikave dhe shërbimeve.



